



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 99

Tiranë – E hënë, 8 maj 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 14, datë 3.5.2017	Për zbatimin e ligjit nr. 33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore”..... 5521
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 51, datë 31.3.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti i përpunimit të mbetjeve urbane, me fuqi të instaluar 2850 kW..... 5530
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 54, datë 18.4.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Market” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike..... 5530
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 55, datë 18.4.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Market” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 5531
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 56, datë 18.4.2017	Mbi fillimin e procedurës për lënien peng të aseteve të shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k., në favor të “Bankës Societe Generale Albania” sh.a..... 5532
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 57, datë 18.4.2017	Mbi miratimin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2017-31.12.2017..... 5533
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 58, datë 18.4.2017	Mbi miratimin e rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror..... 5537
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 59 datë 18.4.2017	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike..... 5541

Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 160, datë 14.4.2017	Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Ardian Marku, anëtar i këshillit të bashkisë Lezhë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.....	5541
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.161, datë 14.4.2017	Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Xhevdet Sopaj, anëtar i këshillit të bashkisë Kukës, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.....	5547
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 2498, datë 21.4.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rehabilitimi i qendrës së fshatit Brataj” Selenicë.....	5554
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 2565, datë 25.4.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rivitalizim i pjesshëm pranë rrugës pedonale ‘Abaz Bej Lushnja’ Lushnjë”.....	5554
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 2601, datë 26.4.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikonstruksion i shkollës së mesme të përgjithshme ‘18 Tetori’, Lushnjë”.....	5555
Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr.1356/5, datë 26.4.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikonstruksioni i rrugës “Unaza e jashtme e qytetit”, bashkia Gjirokastrë.....	5555
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetases Tefta Kallaku.....	5556
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetases Vathe Musa Dulja.....	5556

**UDHËZIM****Nr. 14, datë 3.5.2017****PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.33/2017
“PËR PAGESËN DHE FSHIRJEN/
SHUARJEN E DETYRIMEVE TATIMORE,
DETYRIMEVE TË PAGUESHME NË
DOGANË, SI DHE PROCEDURËN E
HEQJES NGA QARKULLIMI TË
MJETEVE TË TRANSPORTIT PAS
FSHIRJES/ SHUARJES SË DETYRIMEVE
TATIMORE”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 15 të ligjit nr. 33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen e pjesshme të detyrimeve tatimore, doganore, si dhe procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes së detyrimeve tatimore”, Ministri i Financave

UDHËZON:**I. OBJEKTI I UDHËZIMIT**

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurën e zbatimit të ligjit nr.33/2017 datë “Për pagesën dhe fshirjen e pjesshme të detyrimeve tatimore, doganore, si dhe procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes së detyrimeve tatimore”, më poshtë referuar si “ligji”.

II. SUBJEKTET PËRFITUESE.

Në zbatim të nenit 3, të ligjit, subjektet që do të përfitojnë të drejtën për pagesën dhe fshirjen e pjesshme të detyrimeve tatimore, janë si më poshtë:

a) Subjektet e regjistruar në regjistrin aktiv, pasiv ose të çregjistruar, për detyrime tatimore ndaj administratës tatimore qendrore dhe vendore, sipas nenit 5, 6, 7 dhe 11 të ligjit;

b) Subjektet debitorë ndaj administratës doganore për detyrime sipas neneve 9, 10 dhe 11 të ligjit;

c) Subjektet pronarë të mjeteve të transportit, siç përcaktohet në nenin 12 të ligjit.

III. SUBJEKTET QË NUK PËRFITTOJNË

1. Në zbatim të nenit 4 të ligjit, nga fshirja/shuarja e detyrimeve nuk përfitojnë subjektet që kanë detyrime tatimore/doganore, të cilët janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën tatimore dhe/ose doganore, në kuptim të legjislacionit të fushës.

2. Organi tatimor qendror apo vendor dhe organi doganor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga

data e hyrjes në fuqi e këtij udhëzimi, duhet të përgatisë listën e tatimpaguesve që nuk përfitojnë nga fshirja/shuarja e detyrimeve. Kjo listë përditësohet çdo muaj.

3. Listat e detajuara dhe të përditësuara do të shërbejnë për njoftim zyrtar të tatimpaguesve që përjashtohen nga zbatimi i ligjit.

4. Njoftimi zyrtar i tatimpaguesve të cilët përjashtohen nga zbatimi i ligjit, do të bëhet në faqen zyrtare të organit tatimor qendror/vendor/doganor brenda 45 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij udhëzimi. Ky njoftim përditësohet çdo muaj sipas vendimeve të gjyqësore të formës së prerë për veprat penale në fushën tatimore dhe/ose doganore të marra pas këtij afati.

IV. FSHIRJA E DETYRIMEVE TATIMORE

1. Fshihen/shuhen automatikisht detyrimet tatimore të papaguara sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 2 të ligjit, që i përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë, dhe që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e subjektit, përveç kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Këtu përfshihet çdo detyrim tatimor i regjistruar në sistemin informatik ose jashtë sistemit, por që është i regjistruar në kontabilitetin e drejtorive rajonale tatimore.

1.1 Fshihen/shuhen detyrimet e akcizës të administruara nga ana e organit tatimor që i përkasin periudhave deri në 31 dhjetor 2010.

2. Fshihen/shuhen detyrimet e papaguara të përcaktuara sipas ligjit nr. 9632/2006 “Për taksat vendore” i ndryshuar, që u përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë sipas regjistrimeve të pushtetit vendor.

3. Fshihen/shuhen automatikisht dënimet administrative (gjobat) dhe kamatëvonesat për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, që i përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë, që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e subjektit.

4. Për rastet kur data e njoftim vlerësimit apo akt konstatimit mban datën 31.12.2010 dhe më parë, ndërsa data e kontabilizimit është bërë pas kësaj date, fshirja/shuarja bëhet manualisht nga strukturat përkatëse.



V. FSHIRJA/SHUARJA PJESORE E DETYRIMEVE TATIMORE ME KUSHT PAGIMIN E TATIMIT/TAKSËS/TARIFËS /KONTRIBUTIT

1. Fshihen/shuhet gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të regjistruara në llogarinë e subjektit, me kushtin që deri më 31.12.2017, të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi, për:

a) detyrimet tatimore, që i përkasin periudhave tatimore janar 2011 deri dhjetor 2014, duke u aplikuar sipas llojit të tatimit;

b) kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që i përkasin periudhave tatimore janar 2011 deri dhjetor 2014;

c) taksat/tarifat vendore të papaguara, që u përkasin periudhave tatimore janar 2011 deri dhjetor 2014;

2. Ky përcaktim zbatohet edhe në rastin kur tatimi/taksa/tarifa/kontributi është paguar përpara hyrjes në fuqi të ligjit. Nëse subjekti për një periudhë të caktuar nuk ka tatim për të paguar për periudhat tatimore sipas llojit të tatimit që i përkasin periudhave janar 2011 deri në dhjetor 2014, duke qenë se e ka paguar më parë ose tatimi ka qenë zero, atëherë atij i aplikohet fshirja/shuarja e kamatëvonesave dhe gjobave sipas përcaktimeve në nenin 6 të ligjit dhe kësaj pike të udhëzimit.

3. Për rastet kur data e njoftim vlerësimit apo akt konstatimi mban datën 31.12.2014 dhe më parë, ndërsa data e kontabilizimit është bërë pas kësaj date, fshirja/shuarja bëhet manualisht nga strukturat përkatëse.

4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të dërgojë zyrtarisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave detyrimet e tatimpaguesve për akcizë/gjobë/ kamatëvonesë e dënim administrativ për periudhën tatimore janar 2011 deri dhjetor 2014 sipas periudhave që i përkasin. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për këtë tatim do të zbatojë procedurën e fshirjes/shuarjes pjesore të detyrimeve të akcizës, në zbatim të dispozitave të nenit 6 të ligjit.

VI. FSHIRJA/SHUARJA E DETYRIMEVE TATIMORE TË TJERA.

Janë gjithashtu objekt i fshirjes/shuarjes sipas ligjit, detyrimet tatimore të mëposhtme, pavarësisht periudhës tatimore që i përkasin:

1. Fshihen/shuhet automatikisht detyrimet tatimore përfshirë tatimin/kontributin / taksën/tarifën, kamatëvonesën dhe dënimet administrative për subjektet persona fizikë ose juridike, të cilët rezultojnë të çregjistruar në QKB, me vendim gjykate, ose që janë të çregjistruar në administratën tatimore deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit.

1.1 Organi tatimor qendror/vendor përgatit listën e subjekteve sipas përcaktimeve të mësipërme, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të udhëzimit.

1.2 Tatimpaguesit përfitues të ligjit sipas listës së përgatitur, pas kryerjes së fshirjes së detyrimeve nga sistemi, në mënyrë automatike do të çregjistrohen nga sistemi me datën efektive të çregjistrimit sipas listës pa qenë e nevojshme dorëzimi i deklaratave dhe listëpagesave të padorëzuara.

1.3 Për detyrimet vendore, organet e pushtetit vendor marrin masat për fshirjen e detyrimeve nga regjistrat përkatës.

1.4 Tatimpaguesit të cilët rezultojnë të çregjistruar në QKB, me vendim gjykate, ose që janë të çregjistruar në administratën tatimore deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk kanë detyrime tatimore të papaguara, në mënyrë automatike do të çregjistrohen nga sistemi me datën efektive të çregjistrimit sipas listës pa qenë e nevojshme dorëzimi i deklaratave dhe listëpagesave të padorëzuara.

2. Në zbatim të nenit 7 të ligjit, fshihen/shuhet në mënyrë automatike dënimet administrative (gjobat) tatimore të llogaritura automatikisht nga sistemi për deklaram të vonuar sipas nenit 113 të ligjit nr. 9920, datë 19.08.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, deri më 31.12.2016, përfshirë edhe dënimet që lidhen me afatin e deklaramit të të punësuarve pavarësisht periudhës tatimore që i përkasin.

3. Fshihen/shuhet automatikisht dënimet administrative (gjobat) për dorëzim të vonuar të vendimit për destinimin e rezultatit dhe dorëzim me vonesë të pasqyrave financiare të aplikuar sipas ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, të llogaritura deri në datën 31.12.2016 pavarësisht periudhës tatimore që i përkasin.

4. Fshihen/shuhet automatikisht dënimet administrative (gjobat) për mosdeklaram në afat,



për deklarata të padorëzuara, me kusht që çdo deklaratë e padorëzuar të dorëzohet deri në datën 30.06.2017 pavarësisht periudhës tatimore që i përket.

5. Fshihen/shuhen automatikisht dënimet administrative (gjobat) për shoqëritë e autorizuar, të parashikuara në nenin 123 të ligjit nr. 9920, datë 19.08.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të evidentuara në llogarinë e subjektit nëpërmjet akt konstatimit deri më datën 31.12.2016 pavarësisht periudhës tatimore që i përket.

6. Fshihen/shuhen automatikisht dënimet administrative (gjobat) si rezultat i aplikimit të dispozitave të ligjit nr.99/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese pavarësisht periudhës tatimore që i përket.

7. Përveç sa parashikohet në nenin 5, fshihen/shuhen detyrimet tatimore të papaguara sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 2 të këtij ligji, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe të detyrimeve të vetëdeklaruar dhe të papaguara, të shoqërive që operojnë në sektorin elektro-energjitik dhe janë 100 % me kapital shtetëror, që i përketin periudhave tatimore nga 1.1.2011 deri 31.12.2013.

Gjobat dhe kamatëvonesat për kontributet e sigurimeve dhe detyrimet e vetëdeklaruar për këto periudha, fshihen/shuhen, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi.

7.1 Për detyrimet e këtyre shoqërive për periudhën janar deri dhjetor 2014, fshihen/shuhen gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kushtin që brenda datës 31.12.2017, të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi.

7.2 Në zbatim të referimeve të mësipërme, ngarkohet organi tatimor të evidentojë dhe të përcaktojë subjektet e këtij sektori që përmbushin kushtet. Nga ana e tij duhet të përcaktohet qartë detyrimi tatimor që do të fshihet sipas përcaktimeve ligjore.

Për pagesën e detyrimeve të këtij sektori, përcaktohet një plan pagesash periodik i cili

shtrihet nga hyrja në fuqi e ligjit deri në dhjetor 2017, për pagimin e tatimit/taksës/kontributit brenda datës 31.12.2017.

7.3 Informacioni i detajuar me subjektet e këtij sektori dhe detyrimet që do të fshihen/shuhen, do të përgatitet nga ana e drejtorive rajonale tatimore përkatëse dhe do të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

8. Përveç sa parashikohet në nenin 5, fshihen/shuhen detyrimet tatimore të papaguara sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 2 të këtij ligji, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të shoqërive që operojnë në sektorin ujësjellës-kanalizime dhe janë 100 % me kapital shtetëror, që i përketin periudhave tatimore nga 1.1.2011 deri 31.12.2013. Gjobat dhe kamatëvonesat për kontributet e sigurimeve për këto periudha fshihen/shuhen, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë kontributi.

8.1 Për detyrimet e këtyre shoqërive për periudhën janar deri dhjetor 2014, fshihen/shuhen gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi.

8.2 Në zbatim të referimeve të mësipërme, ngarkohet organi tatimor të evidentojë dhe të përcaktojë subjektet e këtij sektori që përmbushin kushtet. Nga ana e tij duhet të përcaktohet qartë detyrimi tatimor që do të fshihet sipas përcaktimeve.

8.3 Informacioni i detajuar me subjektet e këtij sektori dhe detyrimet që do të fshihen/shuhen, do të përgatitet nga ana e drejtorive rajonale Tatimore përkatëse dhe do të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

9. Shuhen efektet tatimore për detyrime të papaguara të regjistruara ose jo, apo në proces kontrolli, si pasojë e lëshimit jo brenda së njëjtës periudhë tatimore të kryerjes së furnizimit, të dokumentit që vërteton përjashtimin nga TVSH, ose si pasojë e moslëshimit të këtij vërtetimi, me kusht që në çdo rast aplikimi pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore të jetë paraqitur deri më 31.12.2014.



Sipas kësaj dispozite përfitojnë ato raste të cilat është aplikuar në AKBN brenda datës 31.12.2014 dhe AKBN nuk ka lëshuar asnjë dokument/vërtetim për rastin.

Për çdo rast për të cilin ka një dokument/vërtetim të lëshuar nga AKBN i cili nuk ka miratuar përjashtimin nga TVSH, rasti nuk është objekt i dispozitave të pikës “P” të nenit 7 të ligjit.

9.1 Për çdo subjekt që është në proces kontrolli mbahet një proces verbal i veçantë për këtë qëllim, në të cilin në mënyrë analitike listohen rastet si dhe data e aplikimit në AKBN, ka ose jo vërtetim nga AKBN, është miratuar ose jo/ është shprehur AKBN/ose jo, data e miratimit/ refuzimit nëse ka.

Për këta tatimpagues që janë në proces kontrolli ende të papërfunduar, DRT respektive të marrin masat për të përfunduar kontrollet tatimore, duke marrë në konsideratë parashikimet e ligjit.

9.2 Nga ana e organit tatimor, evidentohen tatimpaguesit sipas përcaktimeve të mësipërme për vlerën e detyrimit, llojin e detyrimit, periudhën dhe kushtin e plotësuar.

9.3 Informacioni i detajuar me subjektet që përmbushin kushtin e mësipërm dhe detyrimet që do të fshihen/shuhet, do të përgatitet nga ana e drejtorive rajonale tatimore përkatëse dhe do të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

10. Fshihen/shuhet gjobat dhe kamatëvonesat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të vetëpunësuarit në bujqësi, që i përkasin periudhave nga 1 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2016, me kusht që pagesa e kontributeve të kryhet brenda datës 31.12.2017.

11. Për rastet kur sipas pikave 1-10 të këtij kreu, data e akt konstatimit mban datën 31.12.2016 dhe më parë, ndërsa data e kontabilizimit është bërë pas kësaj date, fshirja/shuarja bëhet manualisht nga strukturat përkatëse.

VII. KOMPENSIMI I DETYRIMEVE DEBITORE ME GJENDJEN KREDITORE DHE TEPRICËN KREDITORE TË TVSH-SË

1. Subjektet që kanë tepricë kreditore të TVSH-së ose të një tatimi tjetër përfitojnë nga fshirja e detyrimeve tatimore sipas neneve 5, 6, 7 dhe 11 të këtij ligji, pas kompensimit (zvogëlimit) të tepricës deri në masën e tatimit të papaguar pa përfshirë gjobat dhe kamatëvonesat si dhe

detyrimet tatimore të pahedhura në sistem që i përkasin periudhave tatimore deri më 31.12.2010.

2. Në rastet kur sipas nenit 6, teprica nuk mbulon vlerën e plotë të tatimit të papaguar atëherë duhet të kryhet pagesa për pjesën e mbetur dhe më pas bëhet fshirja e kamatëvonesave dhe e dënimeve administrative.

3. Përcaktimet e këtij neni për kompensimin zbatohen automatikisht pa kontroll, përveç rasteve të parashikuara në pikën 1 të nenit 11 të këtij ligji, për të cilat ky nen zbatohet kur subjekti heq dorë nga ankimi administrativ ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit pranë gjykatës kompetente.

4. Sipas këtij neni, kompensimit nuk i nënshtrohen detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

5. Kompensimi i tepricës kreditore të TVSH-së dhe çdo lloj tatimi duhet të përdoret për të përputhur fillimisht detyrimet brenda llojit të vetë të tatimit dhe më pas tek tatimet e tjera. Nga ky kompensim përjashtohen detyrimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

VIII. FSHIRJA E DETYRIMEVE TË PAGUESHME NË DOGANË

Në zbatim të neneve 9, 10, dhe 11 të ligjit nr.33/2017 të sipërcituar, degët doganore kryejnë evidentimin e plotë të të gjithë debitorëve ndaj administratës doganore bazuar në përcaktimet e ligjit duke marrë në konsideratë datën e vendimit, llojin e mallit, listën e makinerive dhe pajisjeve të përjashtuara nga pagesa e tatimit mbi vlerën e shtuar që ishte në fuqi deri më 31.12.2016.

Për këtë qëllim degët doganore hartojnë edhe listat respektive të debitorëve sipas procedurave të mëposhtme të përcaktuara në këtë udhëzim.

Për të administruar gjithë procedurën e fshirjes sipas këtij ligji, kryetari i degës doganore ngre një komision në përbërjen e të cilit janë kryetari i degës doganore, juristi i degës doganore, specialisti i borxhit dhe specialisti i financës. Kryetari i degës mund të caktojë në përbërje të këtij komisioni edhe punonjës të tjerë të degës doganore.

IX. PROCEDURA QË DUHET NDJEKUR NGA DEGA DOGANORE NË ZBATIM TË NENIT 9 TË LIGJIT

1. Në zbatim të pikës 1, të nenit 9, të ligjit, dega doganore harton listën e plotë të të gjithë debitorëve, për të cilët detyrimet e pagueshme në



doganë sipas kuptimit të pikës 2 të nenit 2 të ligjit, janë të papaguara dhe të evidentuara nëpërmjet vendimeve administrative deri më 31 dhjetor 2010.

Kjo listë do të përmbajë në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat në lidhje me: emrin e kompanisë/individit, NIPT-in/ID, numrin dhe datën e vendimit administrativ, detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të këtij ligji, shumën e paguar nëse ka, shumën që fshihet/shuhet.

Kjo listë e plotë do të konsiderohet si lista finale mbi të cilën do të vazhdojë procedura e administrimit të fshirjes nga Komisioni.

Komisioni pasi verifikon saktësinë e listës, përmes një procesverbali të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit miraton menjëherë fshirjen e këtyre detyrimeve. Lista e miratuar i kalon për fshirje zyrës së financës dhe zyrës së borxhit në degën doganore.

Lista e debitorëve përfitues, pasi u janë fshirë detyrimet e pagueshme në doganë sipas pikës 1, të nenit 9, të ligjit, i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Debitorët të cilët kanë kryer pagesë të pjesshme të detyrimeve të pagueshme në doganë në zbatim të vendimeve administrative të specifikuara sipas pikës 1 të nenit 9 të ligjit, përfitojnë nga fshirja vetëm për pjesën e papaguar të detyrimeve të pagueshme.

2. Në zbatim të pikës 2, të nenit 9, të ligjit, dega doganore harton listën e plotë të të gjithë individëve debitorë lidhur me produktet e duhanit, për të cilët detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2 të nenit 2 të ligjit, janë të papaguara dhe të evidentuara nëpërmjet vendimeve administrative deri më 31 dhjetor 2016.

Kjo listë do të përmbajë në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat në lidhje me: emrin individit, ID nëse disponohet, numrin dhe datën e vendimit administrativ, detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të këtij ligji, shumën e paguar nëse ka, shumën që fshihet. Kjo listë e plotë do të konsiderohet si lista përfundimtare mbi të cilën do të vazhdojë procedura e administrimit të fshirjes nga Komisioni.

Komisioni pasi verifikon saktësinë e listës, përmes një procesverbali të nënshkruar nga të

gjithë anëtarët e komisionit, miraton fshirjen e këtyre detyrimeve. Lista e miratuar i kalon për fshirje zyrës së financës dhe zyrës së borxhit në degën doganore.

Lista e debitorëve përfitues, pasi u janë fshirë detyrimet e pagueshme në doganë sipas pikës 2, të nenit 9, të ligjit, i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Debitorët të cilët kanë kryer pagese të pjesshme të detyrimeve të pagueshme në doganë në zbatim të vendimeve administrative të specifikuara sipas pikës 2 të nenit 9 të ligjit, përfitojnë nga fshirja vetëm për pjesën e papaguar të detyrimeve të pagueshme.

3. Në zbatim të pikës 3, të nenit 9, të ligjit, dega doganore brenda 60 ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi harton listën e plotë të të gjithë debitorëve të cilat janë të evidentuara nga administrata doganore deri në përfundim të afatit të zbatimit të ligjit, për TVSH-në e shtyrë dhe të papaguar për makineritë e pajisjet, importimi i të cilave është përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, sipas listës përkatëse në fuqi, deri në datë 31.12.2016.

Kjo listë do të përmbajë në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat në lidhje me: emrin e kompanisë/individit, NIPT-in/ID, shumën e detyrimeve të pagueshme, kodin tarifar sipas NKM për makineritë dhe pajisjet, detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të këtij ligji, shumën e paguar nëse ka, shumën që fshihet/shuhet.

Lista e plotë e përgatitur nga dega doganore do të konsiderohet si lista përfundimtare mbi të cilën do të vazhdojë procedura e administrimit të fshirjes/shuarjes nga komisioni;

Komisioni pasi verifikon saktësinë e listës, përmes një procesverbali të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit, miraton fshirjen/shuarjen e këtyre detyrimeve. Lista e miratuar i kalon për fshirje zyrës së financës dhe zyrës së borxhit në degën doganore.

Lista e debitorëve përfitues, pasi u janë fshirë/shuar detyrimet e pagueshme në doganë sipas pikës 3, të nenit 9, të ligjit, i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Debitorët të cilët kanë kryer pagese të pjesshme të detyrimeve të pagueshme në doganë në zbatim të vendimeve administrative të specifikuara sipas pikës 3 të nenit 9 të ligjit,



përfitojnë nga fshirja vetëm për pjesën e papaguar të detyrimeve të pagueshme.

X. PAGESA E DETYRIMIT DHE FSHIRJA ME KUSHT E DETYRIMEVE TË PAGUESHME NË DOGANË NË ZBATIM TË NENIT 10 TË LIGJIT

1. Në zbatim të pikës 1, të nenit 10, të ligjit, dega doganore brenda 15 ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, harton listën e plotë të të gjithë debitorëve për të cilët detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të ligjit, janë të papaguara dhe të evidentuara sipas vendimeve administrative nga 1 janari 2011 deri 31 dhjetor 2014.

Kjo listë do të konsiderohet si lista bazë në të cilën:

a) Do të pasqyrohen debitorët sipas pikës 1, të cilët nuk kanë kryer asnjë pagesë dhe vendimi administrativ ka të përcaktuara detyrime të pagueshme sipas pikës 2 të nenit 2, të ligjit.

b) Do të pasqyrohen debitorët të cilët kanë përmbushur pjesërisht kushtin e pagesës (debitori ka kryer pagesë të pjesshme të detyrimit të pagueshëm në doganë pa përfshirë gjokat, kamatëvonesat dhe interesat kompensuese), deri në momentin e hartimit të kësaj liste.

c) Do të pasqyrohen debitorët të cilët e kanë përmbushur plotësisht kushtin e pagesës (pagesa e plotë e detyrimit të pagueshëm në doganë pa përfshirë gjokat, kamatëvonesat dhe interesat kompensuese).

d) Do të pasqyrohen debitorët të cilët janë shpallur të tillë sipas vendimit administrativ të degës doganore vetëm për gjobë dhe/ose kamatëvonesa dhe/ose interesa kompensuese.

Lista e debitorëve sipas pikës 1 do të përmbajë në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat në lidhje me: emrin e kompanisë/individit, NIPT-in/ID, numrin dhe datën e vendimit administrativ, detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të këtij ligji, shumën e paguar nëse ka, shumën që duhet paguar për të plotësuar kushtin e fshirjes, shumën që fshihet.

1.1 Për debitorët e përfshirë në listë sipas germës “a” dhe “b” të pikës 1, zbatohet procedura si më poshtë vijon:

Për të gjithë këta debitorë, nëse nuk është kryer procedura e njoftimit, dega doganore bën menjëherë njoftimin e debitorit në të cilin sqaron gjithashtu, edhe kushtin për pagesën e pjesës së

plotë të detyrimit të pagueshëm në doganë pa përfshirë gjokat, kamatëvonesat dhe interesat kompensuese.

Të gjithë debitorët përfitues, duhet që brenda datës 31.12.2017 të paraqesin zyrtarisht pranë degës doganore ku figurojnë debitorë, kopjen e mandatit pagesës që përfaqëson pagesën sipas kushtit.

Mandati i pagesës së kryer nga debitori dhe kopja e deklaratës së amenduar i bashkëlidhen listës bazë për verifikim nga Komisioni. Gjithashtu kopje e mandatit të pagesës së kryer nga debitori dhe kopje e deklaratës së amenduar bëhen pjesë e dosjes përkatëse të debitorit.

Komisioni çdo fillim muaji analizon dhe verifikon listën e këtyre debitorëve dhe dokumentet bashkëlidhur, harton një procesverbal të detajuar në të cilin përcakton rastet që përfitojnë dhe ato që nuk përfitojnë, duke dhënë edhe sqarimet përkatëse. Ky procesverbal nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

Debitorët të cilët kanë paguar një pjesë të detyrimit të pagueshëm në doganë e specifikuar në gemën “b” të pikës 1, përfitojnë nga falja vetëm për pjesën e mbetur të detyrimit të pagueshëm në doganë të përbërë nga gjoka, kamatëvonesa dhe interesa kompensuese nëse është plotësuar kushti i pagesës bazuar në dispozitat e ligjit.

Në rast të mosplotësimit të kushtit (pagesës jo të plotë të 100% të detyrimit të pagueshëm në doganë, pa përfshirë gjokat, kamatëvonesat dhe interesat kompensuese), Komisioni nuk miraton fshirjen e detyrimeve të pagueshme në doganë dhe për këtë vendimarrje njofton debitorin.

Për debitorët të cilët kanë plotësuar kushtin e pagesës, komisioni miraton fshirjen. Lista e miratuar i kalon për fshirje zyrës së financës dhe zyrës së borxhit në degën doganore.

Lista e debitorëve përfitues sipas kësaj pike, pasi u janë fshirë detyrimet e pagueshme në doganë si më lart, i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

1.2 Për debitorët që përshihen në germenat “c” dhe “d” të pikës 1, Komisioni verifikon saktësinë e listës. Lista për çdo debitor të germës “c” që ka përmbushur kushtin e pagesës duhet të ketë bashkëngjitur kopjen e deklaratës së amenduar.

Komisioni pas verifikimit mban një procesverbal të nënshkruar nga të gjithë anëtarët



e Komisionit dhe miraton menjëherë fshirjen e detyrimeve të pagueshme në doganë. Për debitorët e përfshirë në germen “d”, të pikës 1 Komisioni miraton menjëherë fshirjen e gjobave, kamatëvonesave dhe/ose interesave kompensuese.

Lista e miratuar i kalon për fshirje zyrës së financës dhe zyrës së borxhit në degën doganore.

Lista e debitorëve të cilët kanë përfituar nga falja dhe fshirja e detyrimeve të pagueshme sipas kësaj pike, i dërgohet edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

2. Në zbatim të pikës 2, të nenit 10, të ligjit, dega doganore brenda 15 ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, harton listën e plotë të debitorëve të evidentuara nëpërmjet vendimeve administrative nga 1 janar 2011 deri në 31 dhjetor 2016, dhe që janë shpallur debitorë vetëm për shkelje të regjimit të lejimit të përkohshëm, për të cilët detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të ligjit, janë të papaguara.

Dega doganore, për debitorët e përfshirë në listën e pikës 2 do të zbatojë të njëjtën procedurë të përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu.

XI. DETYRIMET TATIMORE DHE DOGANORE QË JANË NË PROCES ANKIMIMI NË ZBATIM TË NENIT 11 TË LIGJIT

1. Subjekti i cili është në proces ankimimi administrativ ose gjyqësor për detyrimet tatimore/detyrimet e pagueshme në doganë, i nënshtrohet këtij ligji nëse ai heq dorë nga ankimi administrativ ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit pranë gjykatës administrative kompetente.

1.1 Të gjithë tatimpaguesit për gjobat e parashikuara në nenin 7 të ligjit, pikat b, c, ç, d, dh, përfitojnë nga zbatimi i ligjit të fshirjes, pavarësisht nëse janë në proces ankimimi.

1.2 Për këtë qëllim, lista e subjekteve të cilat janë në proces gjyqësor për vlerën dhe periudhën e detyrimit të ankimuar, do të përcaktohen nga ana e organit tatimor/doganor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e udhëzimit. Lista e subjekteve të cilat janë në proces gjyqësor, do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të administratës tatimore/doganore.

1.3 Në momentin kur subjekti paraqet pranë organit tatimor/doganor aktin e heqjes dorë nga ankimi administrativ ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit, bëhet pjesë e shqyrtimit të ligjit të faljes.

2. Çdo drejtori rajonale tatimore, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të rishikojë të gjitha marrëveshjet e pagesës me këste të detyrimit të papaguar, me qëllim përfshirjen e këtyre tatimpaguesve në procesin e shqyrtimit të ligjit të fshirjes.

3. Administrata tatimore apo doganore për detyrimet që fshihen/shuhen sipas këtij ligji, në rastin kur i ka filluar, ndërpret procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve. Për detyrimet tatimore ose doganore që nuk përfitojnë nga falja sipas këtij ligji, procedurat e mbledhjes së detyrimeve vijojnë të kryhen sipas përcaktimeve në legjislacionet përkatëse.

3.1 Për detyrimet tatimore që nuk përfitojnë nga falja sipas këtij ligji, procedurat e mbledhjes së detyrimeve vijojnë të kryhen sipas përcaktimeve në kreun XI “Mbledhja me forcë i detyrimit tatimor të papaguar” të ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, të ndryshuar.

3.2 Për detyrimet doganore që nuk përfitojnë nga falja sipas këtij ligji, procedurat e mbledhjes së detyrimeve vijojnë të kryhen sipas përcaktimeve në Kodin Doganor dhe dispozitave zbatuese të tij.

XII. PROCEDURA E HEQJES NGA QARKULLIMI TË MJETEVE QË NUK JANË NË PËRDORIM DHE FSHIRJES SË DETYRIMEVE TATIMORE PËR KËTO MJETE

1. Hiqen nga qarkullimi të gjitha mjetet e regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, për të cilat nuk është kryer asnjë veprim me taksat për këto mjete pas datës 31 dhjetor 2011 e në vijim.

“Veprim”, nënkuptohen datën e pagesës së taksës në DPSHTRR, pavarësisht vitit të cilit i përkasin, apo afatit të vlefshmërisë së tyre.

2. Heqja nga qarkullimi e këtyre mjeteve bëhet pasi fshihen/shuhen detyrimet tatimore të papaguara për to, si: taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve dhe taksën vjetore të qarkullimit rrugor, taksa vjetore e mjeteve të përdorura, taksa e mjeteve luksoze, si dhe gjobat e llogaritura për efekt të mospagimit të taksave.



Subjektet/personat përgjegjës kanë të drejtë që brenda datës 31.12.2017, të paraqiten pranë drejtorive rajonale për të kryer, pa pagesë, veprimet përkatëse të heqjes nga qarkullimi të mjetit rrugor, e të dorëzojnë:

a) dokumentit e identifikimit të personit përgjegjës;

b) formularin e vetëdeklarimit për shkatërrimin, skrapimin e mjetit, sipas modelit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRr);

c) certifikatën e pronësisë;

d) lejen e qarkullimit;

e) targat e mjetit.

Në rastet kur subjektet/personat përgjegjës, nuk disponojnë këto dokumente DRSHTTRr-të, bën heqjen nga qarkullimi të mjetit rrugor, brenda datës 31.12.2017, pasi subjekti/personi përgjegjës të dorëzojë formularin e vetëdeklarimit, sipas modelit të përgatitur nga DPSHTRr-ja, për:

a) shkatërrimin, skrapimin të mjetit;

b) mungesën e certifikatës së pronësisë;

c) mungesën e lejes së qarkullimit;

d) mungesën e targave.

Shembull:

a- Subjekti/personi përgjegjës i mjeti me targë TRxxxxA i cili ka paguar taksat për herën e fundit në DPSHTRr me datën 31.12.2011, pavarësisht vitit të cilit i përketin taksat, apo afatit të vlefshmërisë së tyre, ka të drejtë të kërkojë heqjen nga qarkullimi pranë Drejtorisë Rajonale ku mjeti është i regjistruar brenda datës 31.12.2017.

DRSHTRr përkatëse pasi fshin/shuan detyrimet tatimore të papaguara për to, bën heqjen nga qarkullimi të mjetit.

b- Subjekti/personi përgjegjës i mjeti me targë TRxxxxA ka paguar taksat për herë të fundit në DPSHTRr me datën 31.12.2012, pavarësisht vitit të cilit i përketin, apo afatit të vlefshmërisë së tyre dhe kërkon heqjen nga qarkullimi të mjetit pranë drejtorisë rajonale ku mjeti është i regjistruar, përfiton nga gjobat e llogaritura për efekt të mospagimit të taksave për periudhën janar 2011 deri dhjetor 2014, me kushtin që subjektet/personat përgjegjës, brenda datës 31.12.2017, të kryejnë pagesën e të gjitha detyrimeve të taksës për periudhën janar 2011 deri taksën e vitit 2017 me përjashtim të gjobave dhe kamtvonesave për periudhën janar 2011 deri dhjetor 2014.

3. Subjektet/personat përgjegjës të cilët paraqiten me dokument identifikimi dhe kërkojnë moskryerjen e procedurës së heqjes nga qarkullimi të mjetit ose mbajtjen aktiv të tij, u fshihen detyrimet tatimore për periudhat dhjetor 2010 e më parë, me kusht që të paguajnë detyrimet për periudhën Janar 2011 e në vijim, me përjashtim të gjobave për mos pagesë të taksave të periudhës Janar 2011 deri me Dhjetor 2014 të cilat fshihen/shuhet me kushtin e pagesës së të gjitha detyrimeve.

Shembull:

Subjekti/personi përgjegjës i mjeti me targë TRxxxxA paraqitet pranë drejtorisë rajonale ku mjeti është i regjistruar për të mbajtur mjetin në qarkullim(akti), ai përfiton nga gjobat e llogaritura për efekt të mospagimit të taksave për periudhën janar 2011 deri dhjetor 2014, me kushtin që subjekti/personi përgjegjës, brenda datës 31.12.2017, të kryej pagesën e të gjitha detyrimeve të taksës për periudhën janar 2011 deri taksën e vitit 2017 me përjashtim të gjobave dhe kamtvonesave për periudhën janar 2011 deri dhjetor 2014.

4. Gjithashtu përfitojnë nga fshirja pjesore e detyrimeve, pra fshihen gjobat e llogaritura për efekt të mospagimit të taksave të mjeteve që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji për periudhën janar 2011 deri dhjetor 2014, me kushtin që subjektet/personat përgjegjës, të paraqiten pranë DPSHTRr-së për të kryer pagesën totale të taksave të prapambetura.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me hyrjen në fuqi të ligjit, nëpërmjet strukturave të saj, harton listën e mjeteve që janë objekt i pikës 1 dhe 2, të nenit nr.12 të ligjit 33/2017, datë 30.3.2017 dhe e publikon atë në faqen zyrtare të saj në adresën www.dpshttrr.gov.al.

Personat e interesuar mund të bëjnë verifikimin e targës së mjetit në këtë listë dhe subjektet/personat përgjegjës paraqiten në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor ku mjeti është i regjistruar, për të vazhduar procedurat e mëtejshme sipas këtij udhëzimi.

Subjektet/personat përgjegjës që disponojnë mjete të cilat nuk janë të përfshirë në listën e mësipërme, dhe plotësojnë kriteret e mësipërme për heqjen nga qarkullimi, paraqiten ose



dërgojnë në rrugë postare të dhënat për mjetet e tyre në Drejtoritë Rajonale ku kanë mjetin e regjistruar.

6. Nëse brenda datës 31.12.2017, personat e interesuar nuk paraqiten për të kërkuar mbajtjen aktiv të mjetit, DPSHTRR-ja do të kryejë pa pagesë, heqjen nga qarkullimi të mjetit dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore të tij.

Lista e mjeteve me targat përkatëse të regjistruara sipas këtij ligji, i dërgohet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit për bllokimin dhe sekuestrimin e tyre në rast se konstatohen në qarkullim. Strukturat e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, kryejnë procedurat e sekuestrimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor nëpërmjet drejtorive rajonale, merr masa për evidentimin, fshirjen/shuarjen dhe sistemimin e detyrimeve të taksave që parashikohen nga ligji nr. 33/2017, datë 30.3.2017. Procesi i dokumentimit fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore objekt i këtij ligji nga ana e DPSHTRR-së do të kryhen brenda 6 muajve pas afatit përfundimtar të zbatimit të këtij ligji.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRr), harton procedura më të detajuara për zbatimin e ligjit dhe të këtij udhëzimi.

XIII. AFATI I ZBATIMIT DHE E DREJTA E ANKIMIT

1. E drejta e subjekteve që përfitojnë nga dispozitat e këtij ligji ushtrohet deri më 31.12.2017.

2. Subjektet për të cilët fshirja e detyrimit aplikohet me kusht, nuk përfitojnë fshirje të detyrimit, nëse nuk përmbushin kushtet brenda afateve të përcaktuara në ligj.

3. Për çdo subjekt që përfiton ose jo nga fshirja e detyrimeve, organi përkatës nxjerr një akt administrativ për këtë qëllim duke njoftuar edhe subjektin.

3.1 Administrata tatimore pas përfundimit të fshirjes/shuarjes sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr.33/2017, do të njoftojë tatimpaguesit në *e-Filing system* me anë të një mesazhi i cili në përmbajtje të tij do të informojë se:

Në zbatim të ligjit nr. 33 datë 30/3/2017 "Për pagesën dhe fshirjen e pjesëve të detyrimeve tatimore, doganore, si dhe procedura e heqjes nga qarkullimi të

mjeteve të transportit, pas fshirjes së detyrimeve tatimore "Ju njoftojmë se efekti i tij është përfshirë në Situatën Tuaj Financiare në sistemin informatik".

4. Për çdo subjekt që përfiton ose jo nga fshirja/shuarja e detyrimeve, organi përkatës nxjerr një akt administrativ për këtë qëllim, duke njoftuar edhe subjektin.

5. Subjektet të cilët sipas një vendimi të administratave përkatëse, nuk përfitojnë nga fshirja sipas këtij ligji, kanë të drejtë të ankohen në gjykatën administrative sipas legjislacionit të fushës në fuqi.

XIV ORGANET ZBATUESE DHE AFATI PËR FSHIRJEN E DETYRIMEVE TATIMORE DHE DETYRIMEVE TË PAGUESHME NË DOGANË.

1. Brenda datës 31.12.2017, organet përkatëse fshijnë nga regjistrat e tyre kontabël dhe nga llogaria e subjektit debitor, detyrimet që fshihen sipas këtij ligji.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi administrata tatimore, qendrore/vendore, doganore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me urdhër të brendshëm përcakton detyrat e çdo funksioni dhe njësie të deleguara për zbatimin e këtij ligji.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ngre një grup pune i cili do të monitorojë, zbatimin e ligjit dhe këtij udhëzimi, nga strukturat përkatëse në nivel qendror dhe rajonal.

5. Drejtor i Përgjithshëm i Doganave mund të përcaktojë rregulla më të detajuara për trajtimin e rasteve specifike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Arben Ahmetaj

**VENDIM****Nr. 51, datë 31.3.2017**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBTEK ENERGY” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
IMPIANTI I PËRPUNIMIT TË
MBETJEVE URBANE, ME FUQI TË
INSTALUAR 2850 KW.**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1 germa “a”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për Licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.4 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.5 gjerat “a”, “b”, “c”; “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Ministria e Mjedisit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues të marrëveshjes së koncesionit, me subjektin Albtek Energy sh.p.k. ka lidhur marrëveshjen e koncesionit nr. 11026/7 prot datë 16.12.2014 për një afat 7 vjeçar.

- Subjekti Albtek Energy sh.p.k., nuk ka bërë me dije datën e fillimit të operimit të impiantit pas përfundimit të afatit si më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Albtek Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “Impianti i përpunimit të mbetjeve urbane” me fuqi të instaluar 2850 KW. Afati i licencës do të zgjasë deri në përfundim të kontratës së koncesionit.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM**Nr. 54, datë 18.4.2017**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB
ENERGY MARKET” SH.P.K, NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1 germa “d”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19 pika 1 germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.4.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Market” sh.p.k., në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;



Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “Alb Energy Market” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gjerat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b” “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “a1”, “b1”, “c1”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërinë “Alb Energy Market” sh.p.k., në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 55, datë 18.4.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB
ENERGY MARKET” SH.P.K., NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gjerat “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, gjerat “e”; 5, pika 1 gjerat “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për

dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19 pika 1 gjerat “a” e Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr.96 datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.4.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ALB ENERGY MARKET” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “Alb Energy Market” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gjerat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b” “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Market” sh.p.k., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 56, datë 18.4.2017****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LËNIEN PENG TË ASETEVE TË
SHOQËRISË “ALB ENERGY” SH.P.K,
NË FAVOR TË “BANKËS SOCIETE
GENERALE ALBANIA” SHA**

Në mbështetje të neneve 16; 20 pika “a”; 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” si dhe në zbatim të neneve 6; 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr.119, datë 21.7.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, gjithashtu dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.4.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi kërkesën e shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k., për lënie peng të aseteve në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorit të Tregut,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit” si më poshtë:

• Neni 7, pika 1, germat:

- “a” ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit, është plotësuar;

- “b” - veprimtaria e licencuar, është plotësuar;

- “c” - gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve, është plotësuar;

- “d” - përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare, është plotësuar;

- “e” - arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit, është plotësuar;

- “f” - efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit, është plotësuar;

- “g” - efekti në furnizimin e rregullt e të
Faqe|5532

qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar, është plotësuar;

- “h” - marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen, është plotësuar;

- “i” - deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit, është plotësuar;

- “j” - (Nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt) është plotësuar;

Nëse Bordi i ERE-s e gjykon të nevojshme, mund të kërkojë informacion shtesë nga i licencuari i cili duhet ta dërgojë informacionin e kërkuar brenda 8 ditëve nga marrja e njoftimit, në bazë të pikës 5 të nenit 7 të “Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k., për lënie peng të aseteve në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

**ASETET QË SHOQËRIA “ALB
ENERGY” SHPK, KA KËRKUAR TË LËRË
PENG NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE
GENERALE ALBANIA” SHA**

a) Certifikatë nr. 548628; përshkrimi i pasurisë:

Hec “BELE 2” disponon ndërtesën me S= 609m²,

Tubacion 1502m



Vepra e marrjes sip=235m²
Sipërfaqe trualli =16.594 m²,

b) Certifikatë nr. 548626; përshkrimi i pasurisë:

“Hec Topojan 1” disponon ndërtesën S=372m²,

Tubacion 1502m

Sipërfaqe trualli, S =4641 m²,

c) Certifikatë nr. 548650; përshkrimi i pasurisë:

Nënstacion, S =932m²

VENDIM

Nr. 57, datë 18.4.2017

**MBI MIRATIMIN E KONTRATËS PËR
SHIT-BLERJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NDËRMJET KESH SH.A.
DHE OSHEE SHA PËR TEPRICAT E
ENERGJISË ELEKTRIKE, PËRFSHIRË
TEPRICAT NË KUSHTET E PRURJEVE
TË MËDHA, ME QËLLIM PLOTËSIMIN
E HUMBJEVE NË RRJETIN E
SHPËRNDARJES PËR PERIUdhËN
KOHORE 1.1.2017-31.12.2017**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 5 pika 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 23.6.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 18.4.2017 pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s për miratimin e Marrëveshjes/Kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2017-31.12.2017,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 18, datë 31.1.2017, Bordi i ERE vendosi “Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2017- 31.12.2017”.

- ERE kërkoi opinionin e palëve të interesit si Ministria e Energjisë dhe Industrisë (shkresë nr. 17/6 prot, datë 3.2.,2017), Autoriteti i Konkurrencës (shkresë nr. 122 datë 3.2.2017) në lidhje me këtë vendimarrje.

- Pas përfundimit të afatit 15 ditor të marrjes së mendimeve nga palët e interesuara, rezultoi se ka paraqitur në ERE opinion mbi këtë marrëveshje vetëm Autoriteti i Konkurrencës duke vendosur të përjashtojë nga ndalimi marrëveshjen.

- OSHEE sh.a. nëpërmjet shkresës së saj nr. 1517 prot, datë 18.1.2017 bëri me dije se kjo kontratë është nënshkruar nga të dyja palët, OSHEE sh.a. dhe KESH sh.a. dhe ka nisur një kopje të saj për miratim në ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2017-31.12.2017 (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrît Ahmeti



Nr. 88 prot. datë 27/01/2017

Nr. 1306 prot. datë 17/01/2017

Marrëveshje për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2017-31.12.2017

Ë lidhur sot me datë _____.2017, ndërmjet:

Korporatës Elektroenergetike Shqiptare, KESH sh.a., rregjistruar si person juridik me vendimin Nr.12728, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përfaqësuar nga Z. Agron HETQJA, Administrator i KESH sh.a., që më poshtë do të quhet "Shitësi",

dhe

OSHEE sh.a., rregjistruar si person juridik me vendimin Nr.38587, datë 19.06.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të përfaqësuar nga Z. Adrian ÇELA, Administrator i shoqërisë OSHEE sh.a., që më poshtë quhet "Blerësi",

(të cilët do të referohen veç si më sipër së bashku si "Palët" dhe me vete si "Palë")

Baza ligjore: Ligji Nr.43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", Vendimi Nr.244, datë 30.03.2016, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike",

- Në kushtet kur për vitet 2015 dhe 2016 ka patur marrëdhënie kontraktore me shoqërinë OSHEE sh.a. për shitjen e nga ana e KESH sh.a., të sasive të tepërta të energjisë elektrike ose në rast prurjesh të mëdha, sipas përkufizimit të dhënë në Aktet nënligjore në fuqi, Rregullat e Shitjes të miratuara nga Bordi i ERE, Rregulloren e Shkarkimit të Plotave dhe atë të Sigurisë së Digave, përtej nevojave të klientëve tariforë, nëpërmjet dy kontratave për këtë qëllim, të miratuara përkatësisht me Vendimet nr.12, datë 06.02.2015, nr.26, datë 09.03.2016, dhe nr.174, datë 17.11.2016 të Bordit të ERE-s,
- Në kushtet kur plka 4, e Vendimit nr.244, datë 30.03.2016, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", përcakton se (citohet shprehimisht) "Sasia e tepërt e energjisë elektrike, e krijuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga furnizimi universal, në përputhje me parashikimet e kontratës së regulluar ndërmjet palëve, sipas pikës 2, të këtij neni, i shitet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për mbulimin e humbjeve, sipas çmimit mesatar të Bursës Hungareze, HUPX, për periudhën në të cilën është kryer fëtrimi i energjisë, për produktin/profillin në bandë, siç publikohet në website-in e kësaj burse dhe përcaktohet, në mënyrë të detajuar, në kontratë. Në këtë rast, sasia e shitur Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të tejkalojë sasinë e energjisë që është e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet. Kontrata ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe prodhuesit të energjisë elektrike miratohet nga ERE";

Palët bien dakort si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Kontratës

KESH sh.a., i cili më poshtë do të quhet "Shitësi/Furnizuesi" dhe OSHEE sh.a. (në funksionin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes) që më poshtë do të quhet "Blerësi", lidhin dhe nënshkruajnë këtë kontratë me objekt shit-blerjen e energjisë elektrike pas përmbushjes së sasive kontraktuale me FSHU për furnizimin e klientëve fundorë, në kushtet e tepricës dhe prurjeve të mëdha, sipas përkufizimit të dhënë në aktet nënligjore në fuqi, Rregullat e Shitjes dhe Rregulloren e Shkarkimit të Plotave si dhe atë të Sigurisë së Digave, për mbulimin e pjesës ose të plotë të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, për periudhën kohore 01.01.2017- 31.12.2017.

faqe 1 nga 3

Adresa: Blvd "Bajram Curri" Rruga Viktor Eftimiut 1023
Tiranë
E-mail: ercalb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 222 963
Tel +355 42 236 880
www.ere.gov.al



Neni 2
Detyrimet Kryesore të Palëve

- OSHEE sh.a., përpara çeljes së procedurës së blerjes në treg të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, do të njoftojë KESH sh.a. për sasinë e energjisë elektrike që ka planifikuar të blejë për mbulimin e humbjeve në rrjet, duke i kërkuar me këtë rast KESH sh.a. përcaktimin e sasisë së energjisë elektrike që kjo e fundit mund të shesë për mbulimin e tyre, sasi e cila mund të mbulojë pjesërisht apo plotësisht kërkesën për mbulimin e humbjeve.

KESH sh.a., përpara çeljes së procedurave të shitjes së energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha apo dhe tepërçave, pasi ka realizuar detyrimin kontraktual për FSHU për furnizimin e klienteve fundorë, do të komunikojë shoqërisë OSHEE sh.a. mundësinë e furnizimit me energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, ndërsa kjo e fundit duhet të konfirmojë brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e KESH-it pranimin ose jo të sasisë së energji elektrike të ofruar nga KESH sh.a. për mbulimin e humbjeve.

- Nëse të dyja palët bien dakord për shitjen/lëvrimin e plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, atëherë programimet, nominimet, konfirmimet, lëvrimi dhe matja do të bazohen në Rregullat në fuqi të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe akteve të tjera nenligjore në zbatim.

Neni 3
Çmimi

Çmimi për livrimin e energjisë elektrike sipas kësaj kontrate do të jetë çmimi mesatar të bursës hungarez HUPX për periudhën në të cilën është kryer lëvrimi i energjisë elektrike për produktin/profilin band, sic publikohet në website-in e kësaj burse.

Neni 4
Faturimi dhe Pagesa

- Shitësi do t'i lëshojë Blerësit brenda datë 10, të muajit kalendarik pas livrimit të energjisë elektrike një faturë ku të pasqyrohet sasia dhe vlera totale e energjisë elektrike të lëvruar gjatë periudhës përkatëse të lëvrimit.
- Pagesa e faturës nga ana e blerësit, do të bëhet brenda 60 diteve kalendarike nga dita e lëshimit të faturës përkatëse nga ana e shitësit dhe nëse dita e fundit nuk është Dite Pune, ditën tjetër të punës.
- Interesi i Mospagesës: Pagesat e vonuara do të mbledhin interesin nga Data e Detyrimit, duke e përfshirë edhe atë, por duke përfshirë datën e pagesës me Përqindje Interesi. Për këtë qëllim: Kamatevonesa për pagese të vonuar: norma e interesit që do të aplikohet për çdo ditë vonese të pagesës të jetë masa e Yield – it mesatar të Bonove të Thesarit me maturim 1 vjeçar të publikuar nga Banka e Shqiperise + 3% në vit, të llogaritur nga data e përcaktuar në pikën 2 të nenit 14 të kontratës deri në datën e pagesës së shumës së pa paguar të faturës. Pagesat e vonuara do të mbledhin interesin nga Data e Detyrimit, duke e përfshirë edhe atë, por duke përfshirë datën e pagesës me Përqindje Interesi.

Neni 5
Mos-Performanca Për Shkak të Forcës Madhore apo pamjaftueshmërisë së plotësisht të kërkesës për klientët tariforë

- Përveç se kur specifikohet ndryshe, "Forcë Madhore" për qëllimet e Kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore ("Pala Pretenduese") që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit, për shkak të mëposhtme, por pa u kufizuar me to:
 - defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterikë të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit; ose
 - pezullimi nga OST-ja përkatëse të livrimit, pranimit ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me Programimin sipas Kontratës.
 - defektet apo ndërprerjet në rrjetin e shpërndarjes.
 - defektet apo ndërprerjet në sistemin e gjenerimit të KESH sh.a.
- KESH sh.a. nuk do të shesë/levrojë energji elektrike për OSHEE sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në kushtet kur e ka të pamundur plotësimin e sasisë kontraktuale me FSHU për furnizimin e klienteve fundorë.
- Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore apo pamundësisë objektive të përcaktuara në këtë kontratë, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore



dhe në atë shkallë që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet nuk do t'i merret Palës Pretenduese lidhur me sasinë e palëvruara ose të pamërra.

4. Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për atë që është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jo-detyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të pafitësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimt të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të pafitësisë performuese.
5. Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e lëvrimt për shkak të Forcës Madhore, Blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të pranimit dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimit për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të lëvrimt.
- 6- Në rast të mos lëvrimt të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Shitësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Shitësi, në rastin kur nuk shfajësohet nga Forca Madhore, sic përcaktohet në këtë nen, do t'i paguajë Blerësit një shumë për sasinë e moslëvruar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e cmimit ndërmjet cmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe cmimin më të lartë, nëse ka një të tillë, me të cilin Blerësi e ka blerë ose do ta blinte sasinë e palëvruar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë të cilës do t'i shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentura.
- 7- Në rast të mos pranimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Blerësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Blerësi, në rastin kur nuk shfajësohet nga Forca Madhore, sic përcaktohet në këtë nen, do t'i paguajë Shitësit një shumë për sasinë e papranuar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e cmimit ndërmjet cmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe cmimin më të ulët, nëse ka një të tillë, me të cilin Shitësi e ka shitur ose do ta shiste sasinë e papranuar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë të cilës do t'i shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentura.

Neni 6

Legjislacioni në fuqi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Legjislacioni në fuqi: Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo Kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi të RSH.
2. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve: Përveç kur specifikohet ndryshe, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me Kontratën do t'i referohet fillimisht për zgjidhje ERE-s. Secila palë mund të kërkojë gjithashtu zbatimin nga Gjykata të të drejtave të saj kontraktuale. Gjykata kompetente është gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë.

Neni 7

Miratimi i ERE-s, hyrja në fuqi, efektet dhe zgjidhja e parakohshme

1. Kjo Kontratë, dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjnë në fuqi dhe i shtrijnë efektet pas miratimit nga ERE.
2. Ajo mund të përfundohet, ndryshohet apo zgjidhet përpara datës së mbarimit të saj, vetëm me miratimin nga ERE.

Neni 8

Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme, 2 (dy) për secilën palë.



Faqe 3 nga 3

Adresa: Blvd "Bajram Curri" Rruga Viktor Efthimi 1023
Tiranë
E-mail: erealb@ere.gov.al

Tel/Fax: +355 42 222 963
Tel: +355 42 236 880
www.ere.gov.al

**VENDIM****Nr. 58, datë 18.4.2017****MBI MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR PROCEDURAT E HEQJES SË
LICENCE NË SEKTORIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42 pika 7 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 27 pika 7 të ligjit 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.4.2017, mbasi shqyrtoi relacionin dhe informacionin shtesë të Drejtorive Teknike, në lidhje me miratimin e “Rregullores për procedurat e heqjes së licence në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”,

konstatoi se:

- Me vendimin me nr. 6, datë 19.1.2017 ka nisur procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e draft – “Rregullores për procedurat e heqjes së licence në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

- Me shkresën nr. 94 prot., në datën 26.1.2017, ERE dërgoi draft – “Rregulloren për procedurat e heqjes së licence në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, për marrje mendimi, pranë subjekteve: OST sh.a, KESH sh.a, OSHEE sh.a, FIAA, AREA, Autoritetit i Konkurrencës, AEES, Albpetrol, Shoqatës së Prodhuesve të Vegjël të Energjisë, Shoqërisë Phoenix Petroleum sh.p.k. dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

- Shoqëria OSHEE sh.a. më shkresën e saj nr. 4899 prot, datë 9.2.2017, ka përcjellë në ERE sugjerimet dhe komentet në lidhje me draft – “Rregulloren për procedurat e heqjes së licence në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

- Shoqëria OST sh.a. më shkresën e saj nr. 517/1 prot, datë 15.2.2017, ka përcjellë në ERE sugjerimet dhe komentet në lidhje me draft – “Rregulloren për procedurat e heqjes së licence në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

- Me korrespondencë elektronike datë 9.3.2017 protokolluar në ERE me nr. 220 prot, datë 10.3.2017 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka përcjellë në ERE komentet mbi draft rregulloren për procedurat e heqjes së licence në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregulloren për procedurat e heqjes së licence në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**RREGULLORE
PËR PROCEDURAT E HEQJES SË
LICENCE NË SEKTORIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË
GAZIT NATYROR****Neni 1**
Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 27 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë një trajtim të barabartë e transparent, për të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, për të cilët merret vendimi për të hequr një licencë, përmes vendosjes së procedurave të njëjta për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në rastet e heqjes së një licence.



Neni 3 Objekti

Kjo rregullore përcakton procedurat që aplikohen për heqjen e një licence të dhënë sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, në përputhje me “Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të ERE” dhe “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, “Rregullat dhe procedurat për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”.

Neni 4 Përkufizime

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë Rregullore kur përdoren, do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. “Ligj i energjisë elektrike” do të thotë ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”

2. Ligji i gazit natyror do të thotë ligji 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”

3. “Bordi ” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, që përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji i energjisë elektrike dhe ligji i gazit natyror ”

4. “Enti Rregullator i Energjisë” ose “ERE” është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin e energjisë elektrike dhe ligjin e gazit natyror”.

5. “Licencë” është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike ose të gazit natyror

6. “I licencuar” do të thotë një person që mban një licencë të dhënë në kuptim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

7. “Procedurë për heqjen e licencës” do të thotë një tërësi veprimesh, që kryhen në zbatim të legjislacionit në fuqi me qëllim zbatimin e parashikimeve të kësaj rregulloreje.

8. Të gjithë termat dhe përkufizimet e përdorura në këtë rregullore do të kenë kuptimin e përcaktuar në perifrazimet e ligjit për energjinë elektrike dhe ligjin për gazin natyror.

PJESA E DYTË PROCEDURAT E HEQJES SË NJË LICENCE

Neni 5 Rastet e heqjes së një licence

ERE heq një licencë kur i licencuari:

a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës për energjinë apo gazin natyror të dhënë sipas ligjit për energjinë elektrike dhe ligjit për gazin natyror;

b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;

c) rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve;

ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet në nenin 17 të ligjit të energjisë elektrike ose nenin 14 të ligjit për gazin natyror.

d) bëhet financiarisht i paaftë ose kërkon shpalljen e falimentimit;

dh) me kërkesë të të licencuarit;

e) ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas licencës.

Neni 6 Fillimi i procedurave

Në të gjitha rastet që personat e ngarkuar nga ERE konstatojnë një apo disa nga kushtet e parashikuara në nenin 5 të kësaj rregullore. Grupi i punës i ngritur për këtë qëllim përgatit një informacion për bordin e ERE-s, mbi kushtet e konstatuara si dhe i propozojnë bordit marrjen e një vendimi për të filluar procedurën për heqje licence.

Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedure për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE. Në asnjë rast subjekti I licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107 të ligjit 43/2015 e cila përben titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile

**Neni 7****Njoftimi dhe përmbajtja e tij**

Me nisjen e procedurës për heqjen e një licence, sipas kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe /ose “d” të nenit 5 të kësaj rregulloreje ERE :

a) njofton me shkrim të licencuarin për fillimin e procedurave për heqjen e licencës duke shprehur qartësisht arsyet për heqjen e licencës;

b) respekton të drejtën e të licencuarin për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës;

c) kur është në interesin publik, mund t’i japë të licencuarit 30 ditë kohë, pas përgjigjes së tij me shkrim, që të veprojë në përputhje me kushtet e licencës dhe të shmangë shkakun për heqjen e saj.

Në rast se i licencuari është propozuar për t’u hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat dh dhe/ose e të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje.

Neni 8**Propozimi përfundimtar**

Pas marrjes së përgjigjes më shkrim nga i licencuari sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentet e paraqitur dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari, dhe do t’i propozojnë Bordit.

a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d” të nenit 5 të kësaj rregulloreje dhe atje ka arsye për të hequr licencën;

b) të japë të licencuarit një periudhë prej 30 ditësh për të vepruar në përputhje me licencën dhe për të shmangur shkaqet për heqjen e tij, në përputhje me nenin 7 paragrafi 1 pika “c” të kësaj rregulloreje; ose

c) për të hequr licencën.

Neni 9**Vendimi i Bordit**

Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:

a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës;

b) të japë të licencuarit një periudhë prej 30 ditësh për të vepruar në përputhje me licencën dhe për të shmangur shkaqet për heqjen e saj;

c) të hequr licencën subjektit i kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d” të nenit 5 të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje; ose

d) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.

2. Në rast se Bordi merr vendim në bazë të shkronjës “b” të pikës 1, vendimi i saj përfundimtar për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës ose për të hequr licencën do të merret pas raportit të paraqitur në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje pas skadimit të afatit të dhënë 30 ditë.

3. Bordi merr vendim jo më vonë se në 10 ditë pune pas datës së raportit të dorëzuar në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje.

4. pasi të merret vendimi i Bordit për heqjen e licencës, ERE do të njoftojë Këshillin e Ministrave, për qëllime të dhe në përputhje me nenin 42, pika 8 të ligjit nr.43 / 2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” ose nenit 27, pika 8 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, respektivisht, për procedurat e iniciuara për të licencuarit në gazit natyror në rast se licenca është hequr nga:

a) Prodhuesi i energjisë elektrike, operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, operatori i sistemit të shpërndarjes për energji elektrike, ose furnizuesi i energjisë elektrike, në kuadër të detyrimit të shërbimit publik; ose

b) Operatori i sistemit të transmetimit të gazit natyror, operatori i sistemit të shpërndarjes për gazin natyror, operatori i sistemit të GNL, apo gazit natyror operatorit të sistemit të magazinimit.

Neni 10**Njoftimi për vendimin**

Në përfundim të një procedure për heqje licence, ERE do të njoftojë të licencuarin mbi përfundimin e procedurës së nisur ndaj tij si dhe do t’i dërgojë një kopje të vendimit të Bordit të ERE.

Ky njoftim duhet t’i dorëzohet të licencuarit jo më vonë se 2 ditë pune pas miratimit të vendimit të Bordit.

**Neni 11****Rishikimi dhe ankimimi**

Kundër vendimit të Bordit të ERE për heqjen e licencës, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s rishikimin e tij, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

I licencuari mund të bëjë ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit të Bordit në Fletoren Zyrtare.

Neni 12**Kushte të përkohshme për subjektet e licencuara në sektorin e energjisë elektrike**

- Në rastet kur ERE merr vendim për heqjen e një licence të licencuarit që ushtron veprimtarinë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes apo furnizimit, ndaj të cilit është vendosur detyrimi i shërbimit publik, në mënyrë që asetet, pronë e të licencuarit, të vazhdojnë të shfrytëzohen për sigurinë e furnizimit të energjisë elektrike ndaj konsumatorëve, ERE, bazuar në këtë rregullore, vendos një nga masat e përkohshme, të përcaktuara më poshtë:

- merr vendim për të vendosur nën administrim të kufizuar, për një periudhë të caktuar kohore, shoqërinë së cilës i është hequr licenca, në mënyrë që të sigurohet ushtrimi i aktivitetit dhe operimi i aseteve të saj deri në marrjen e masave sipas kësaj rregulloreje.

- cakton një shoqëri tjetër për kryerjen e veprimtarisë së shoqërisë, së cilës i është hequr licenca, e cila duhet të përmbushë kushtet përkatëse të licencimit;

- merr vendim për të vendosur një administrator të përkohshëm të shoqërisë, së cilës i është hequr licenca, në mënyrë që të sigurohet ushtrimi i aktivitetit dhe operimi i aseteve të saj deri në marrjen e masave, sipas pikës 3 të këtij neni. Në këtë rast, ERE, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, dhe në përputhje me procedurën dhe kriteret për emërimin e administratorit, i cili do të jetë përgjegjës për administrimin e përkohshëm të shoqërisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave emëron një administrator, i cili është përgjegjës për të siguruar

një aktivitet normal, përfshirë edhe operimin e aseteve të shoqërisë, së cilës i është hequr licenca sipas kushteve përkatëse.

2. Për rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ERE përcakton kushtet dhe detyrimet që duhet të zbatohen nga shoqëria së cilës i është hequr licenca, gjatë periudhës së zbatimit të masave të përkohshme. Kompanisë ndaj të cilit ERE aplikon një nga masat përkohshme të parashikuara në pikën 1, në vendimin e ERE i jepet leje e ushtrimit të aktivitetit të përkohshëm sipas kushteve që përcakton ERE.

3. Derisa licenca të transferohet te një shoqëri tjetër, do të aplikohen masat e përkohshme, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj nga data e heqjes së licencës, zbatimi i të cilave monitorohet nga ERE.

Neni 13**Kushte të përkohshme për subjektet e licencuara në sektorin e gazit natyror**

1. Në rastet kur ERE merr vendim për heqjen e një licence të licencuarit që ushtron veprimtarinë e transmetimit, shpërndarjes, operimit të GNL-së ose të operimit të sistemit të depozitimit, ndaj të cilit është vendosur detyrimi i shërbimit publik, në mënyrë që asetet, pronë e të licencuarit, të vazhdojnë të shfrytëzohen për sigurinë e furnizimit të gazit natyror ndaj klientëve, ERE, bazuar në këtë rregullore, vendos një nga masat e përkohshme, të përcaktuara më poshtë:

a) merr vendim për të vendosur nën administrim të kufizuar, për një periudhë të caktuar kohore, shoqërinë së cilës i është hequr licenca, në mënyrë që të sigurohen ushtrimi i veprimtarisë dhe operimi i aseteve të saj deri në marrjen e masave, sipas ligjit;

b) cakton një shoqëri tjetër për kryerjen e veprimtarisë së shoqërisë, së cilës i është hequr licenca, e cila duhet të përmbushë kushtet përkatëse të licencimit;

c) merr vendim, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë, dhe në përputhje me procedurën dhe kriteret për emërimin e administratorit, i cili do të jetë përgjegjës për administrimin e përkohshëm të shoqërisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, për të emëruar një administrator të përkohshëm të shoqërisë, së cilës i është hequr licenca, në mënyrë që të



sigurohet ushtrimi i veprimtarisë së operimit të aseteve të saj deri në marrjen e masave, sipas pikës 3 të këtij neni.

2. Për rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ERE përcakton kushtet dhe detyrimet që duhet të zbatohen nga shoqëria, së cilës i është hequr licenca, gjatë periudhës së zbatimit të masave të përkohshme.

3. Derisa licenca të transferohet te një shoqëri tjetër ose t'i rijepet së njëjtës shoqëri, do të aplikohen masat e përkohshme, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj nga data e heqjes së licencës, zbatimi i të cilave monitorohet nga ERE.

PJESA E TRETË DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14

Amendime të rregullores

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s, në përputhje me “Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të ERE-s” miratuar me vendimin e ERE nr. 96 datë 17.6.2016.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM

Nr. 59 datë 18.4.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE BAZË TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 22, 51 dhe 97 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, pikat 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të ministrave nr. 519 datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, nenit 15 të “Rregullore për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016 dhe rekomandimet nga Sekretariati i Energjisë (Vjenë, Austri) datë 18.4.2017, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.04.2017, pasi shqyrtoi relacionin në lidhje me hartimin e Rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike.

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM

Nr. 160, datë 14.4.2017

PËR SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME PËR FUNKSIONARIN PUBLIK Z. ARDIAN MARKU, ANËTAR I KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015, “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 14.4.2017, me pjesëmarrjen e:

Denar	Biba	kryetar
Hysen	Osmanaj	zv/kryetar
Bledar	Skënderi	anëtar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Ardiان Marku, anëtar i këshillit të Bashkisë Lezhë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

BAZË LIGJORE: Neni 1, neni 10, pika 1, germa “d”, neni 14, neni 15, pika 3 i ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë



funksiione publike”; kreu V, pika 12, 13, 14 i vendimit të Kuvendit nr.17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, KQZ është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:

Deputetët të Kuvendit të Shqipërisë;

Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;

Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Ardian Marku, anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë, rezulton se ka një dënim me vendimin nr.129, datë 24.11.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me 4 muaj burgim (në aplikim edhe të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale), parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar në KQZ, vërtetimin e gjendjes gjyqësore të datës 27.05.2016, të z. Ardian Marku sipas të cilit rezulton se: z. Marku me vendim gjyqësor të formës së prerë, nr. 182, datë 01.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për kryerjen e veprave penale, “Kontrabandës me mallra të tjera”, parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal, është dënuar me 200.000 lekë gjobë si dhe për kryerjen e veprës penale “Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara”, parashikuar nga neni 186/1 të Kodit Penal, është dënuar me 100.000 lekë gjobë.

Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore, për këtë veprë penale, në bazë të nenit 69 të Kodit Penal, është rehabilituar.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka ridërguar edhe njëherë në KQZ, Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore datë 25.01.2017, të z. Ardian Marku

(Nikulaj) sipas të cilit rezulton se, përveç dënimit të mësipërm, me vendim gjyqësor të formës së prerë nr.129, datë 24.11.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është dënuar me 6 muaj burgim, për veprën penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278 paragrafi 2 i Kodit Penal.

Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore, për këtë veprë penale, në bazë të nenit 69 të Kodit Penal, është rehabilituar.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit dhe në të dy Vërtetimet e Gjendjes gjyqësore, rezulton se z. Ardian Marku, nuk e ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit dënimin për veprën penale “Kontrabandës me mallra të tjera”, parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal sipas vendimit nr.182, datë 1.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr.3240/1 prot., datë 7.2.2017, ka dërguar në KQZ në formatin elektronik (CD), listën pjesore të anëtarëve të Këshillave Bashkiakë, të verifikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ku rezulton se; më datë 20.3.2003 z. Ardian Marku ka ndryshuar mbiemrin nga “Nikulaj” në “Marku” i cili është deklaruar edhe në formularin e vetëdeklarimit.

Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr.303/1, datë 20.3.2017 i ka kërkuar KQZ-së verifikimin e të dhënave të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit të z. Ardian Marku. KQZ-ja pas shqyrtimit të të dhënave në dokumentacionin e z. Ardian Marku, vendosi t’ia kalojë rastin për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme.

Më shkresën nr.303/5, datë 04.04.2017, Prokuroria e Përgjithshme, ka dërguar në KQZ vendimin e rezultatit të verifikimit për z. Ardian Marku, me detyrë anëtar i këshillit të Bashkisë Lezhë.

Prokuroria e Përgjithshme ka analizuar veprën dhe dënimin e vendimit nr.129, datë 24.11.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë dhe ka konkluduar se:

Neni 2, pika 1, germa “a” e ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ndalohen të zgjidhen të emërohen apo të ushtrojnë një funksion publik personat që kryejnë një krim të parashikuar nga neni 278 paragrafi i parë, i pestë i gjashtë, i Kodit Penal.



Në momentin që ka hyrë në fuqi ligji nr.138/2015, neni 278, parashikon përkatësisht këto paragrafë:

- (1)prodhimin e armëve dhe municioneve luftarake;

- (5)mbajtjen e armëve, të bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të automatizuar, në mjedise publike;

- (6)kur vepra penale është kryer në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja;

Nëse i referohemi rastit konkret, në arsyetimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, në vendimin e sipërcituar, sqarohet se subjekti e ka kryer veprën penale të armëmbajtjes pa leje, në mjedise publike, (në makinë, në rrugë)..... (Gjatë kontrollit të ngritur nga forcat e policisë së Komisarariatit Lezhë, kanë ndaluar automjetin tip benz, të cilin e drejtonte Ardian Marku dhe gjatë kontrollit të ushtruar në të, poshtë sediljes së shoferit, është gjetur një armë e tipit TT, nr.26844 të cilën i pandehuri e mbante pa leje të organeve kompetente.....) Pavarësisht se në momentin e kryerjes së veprës penale, dispozita e nenit 278 të Kodit Penal nuk e parashikonte si paragraf të ndarë më vete (armëmbajtjen pa leje në mjedise publike) dhe pavarësisht faktit që ky nen ka ndryshuar disa herë ndër vite, ligji nr.138/2015 përcakton qartësisht se në vlerësim të anës objektive, armëmbajtja pa leje në mjediset publike përfshihet si ndalim në nenin 2, pika 1, germa “a” e ligjit nr.138/2015.

Prokuroria e Përgjithshme në vlerësim të anës objektive ka ndryshuar referencën e dispozitës të Kodit Penal, për klasifikimin e veprës penale për të cilën z. Ardian Marku ka marrë dënimin me burgim sipas vendimit nr.129, datë 24.11.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, nga neni 287, paragrafi 2 i Kodit Penal, në kohën e kryerjes së veprës penale, në nenin 287, paragrafi 5 të Kodit Penal në fuqi në kohën e miratimit të ligjit nr.138/2015.

Në përfundim Prokuroria vendosi përfundimin e verifikimeve dhe konstatimin se subjekti deklarues z. Ardian Luigj Marku, me detyrë drejtor ALUIZNI, Lezhë dhe anëtar i këshillit Bashkiak Lezhë përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa “a” të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Nga verifikimi i dokumentacionit, formularit të vetëdeklarimit, vërtetimit të gjendjes gjyqësore,

KQZ-ja konstaton se:

Zoti Ardian Luigj Marku anëtar i Këshillit Bashkiak Lezhë, është dënuar në vitin 2003 për kryerje të veprës penale “Prodhimi dhe mbajta pa leje e armëve luftarake dhe e municioneve”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

Në ligjin nr.138/2015 në nenin 2 pika 1 germa “a”, veç te tjerash thuhet se: “... nuk mund të kandidojë e as të zgjidhen deputet në Kuvendin e Shqipërisë, Kryetar Bashkie apo Këshilltar në Këshillat Bashkiak ... personat që janë dënuar me vendim të formës së prerë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për: a) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë veprë penale, sipas neneve....278, paragrafi i parë, i pestë dhe i gjashtë...”.

Në kohën e dënimit të zotit Ardian Luigj Marku vepra penale e “Prodhimi dhe mbajta pa leje e armëve luftarake dhe e municioneve”, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal kishte tre paragrafë dhe në paragrafin e dytë dispozita parashikonte një dënim i cili varionte nga gjobë deri në 7 vjet burgim.

Në vendimin e datës 3.4.2017 të Prokurorisë së Përgjithshme, është bërë një interpretim i vendimit penal të dënimit të zotit Ardian Luigj Marku, duke analizuar njërin prej elementeve të veprës penale, atë të anës objektive.

Prokuroria e Përgjithshme thotë midis të tjerash në vendimin e saj se:

“... nëse i referohemi rastit konkret, në arsyetimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, në vendimin e sipërcituar, sqarohet se subjekti e ka kryer veprën penale të armëmbajtjes pa leje në mjedise publike. Pavarësisht se në momentin e kryerjes së veprës penale, dispozita e nenit 278 të Kodit Penal, nuk e parashikonte si paragraf të ndarë më vete armëmbajtjen pa leje në mjedise publike, dhe pavarësisht faktit se ky nen ka ndryshuar disa herë ndër vite siç e arsyetua më sipër ligji nr.138/2015, përcakton qartësisht se në vlerësim të anës objektive armëmbajtja pa leje në ambiente publike përfshihet në ndalimet e nenin 2 pika 1 germa “a” e këtij ligji....”.

Në lidhje me këtë arsyetim të vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shprehet se:

Së pari, Prokuroria e Përgjithshme sipas ligjit nr.138/2015, ngarkohet që të bëjë verifikim të thelluar të të dhënave të deklaruara në formularin e



vetëdeklarimit, me iniciativë të saj apo edhe me kërkesë të institucioneve përkatëse. Pra ky organ, sipas këtij ligji është i detyruar që të administrojë vendime penale dënimi, vendime arresti brenda e jashtë vendit, urdhra dëbimi etj.

Në interpretimin që i ka bërë vendimit penal me nr.123, datë 24.11.2003, dhe më konkretisht anës objektive të veprës penale të kryer nga subjekti vetëdeklarues, ky organ në vendimin e tij të datës 03.04.2017, nuk u ka dhënë përgjigje disa dyshimeve dhe konkretisht:

- Ku qëndron ngjashmëria midis nenit 278 (sipas parashikimit të ligjit penal të kohës, të vitit 2003) për të cilën është dënuar subjekti vetëdeklarues Ardian Marku i cili e ka masën e dënimit nga gjobë deri në 7 vjet burgim, dhe nenit 278 (ligji penal në aktual) që i referohet Prokuroria i cili e ka masën e dënimit nga 3 deri në 7 vjet burgim ?

Lehtësisht dallohet një diskordancë shumë e madhe me masat e dënimit të cilat patjetër kanë qenë kritere në caktimin e dispozitave me karakter përjashtues në zbatim të ligjit 138/2015. Pra, legjislatori, ndryshe nga sa ishte parashikuar më parë ka vendosur një masë dënimi dysheme më të madhe se sa parashikohej në vitin 2003, gjë e cila do të thotë një qëndrim i ashpër në lidhje me këtë veprimtari antiligjore. Cila ka qenë arsyeja e barazimit të këtyre dispozitave për llogari të ligjit 138/2015 nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme?

- Njohjen apo interpretimet e vendimeve penale, legjislacioni penal shqiptar këtë të drejtë ia njeh vetëm organeve gjyqësore. Janë këto organe që mund dhe duhet që të bëjnë interpretimin e vendimeve penale. A jemi përpara tejkallimit të veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme kur ajo interpreton vendimin gjyqësor, anën objektive të veprës penale për të cilën është dënuar subjekti vetëdeklarues?

Së dyti, dispozita penale të cilës i referohet organi i akuzës ka një masë dënimi nga 3 deri në 7 vjet burgim c'ka tregon seriozitetin që ligjvënësi i kushton kësaj veprimtarie keqbërëse. Ashpërsimi i masës së dënimit në minimum, referuar qëndrimit të Prokurorisë së Përgjithshme, duket se ndodhemi përpara një cilësimi të ri të veprës penale të kryer nga subjekti vetëdeklarues z. Ardian Marku në vitin 2003. Është parim i gjithëpranuar në doktrinën e së drejtës penale se ligji penal ndëshkues nuk ka fuqi prapavepruese. Ligji penal favorizues ka fuqi

prapavepruese.. Theksojmë se sa më sipër, është në përputhje të plotë edhe më parashikimet e nenit 29 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

As Prokuroria e Përgjithshme e aq më pak Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk mund të ngrenë akuzën jashtë një procesi gjyqësor. Janë këto dallime midis veprës së kryer dhe asaj që i referohemi për heqjen e mandatit, që e kanë lejuar gjykatën për të aplikuar lehtësirat e parashikuara në ligjin penal.

Detyrat dhe funksionet e organit të prokurorisë janë të mirëpërcaktuara në një grupim ligjesh, duke filluar nga:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e cila në nenin neni 148 të saj, paragrafi i parë parashikon shprehimisht se:

“1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. Detyra konkrete të saj janë parashikuar në ligjin organik të saj e konkretisht në ligj”.

- Ligjin nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 Objekti i veprimtarisë së prokurorisë ku parashikohet shprehimisht se:

“1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të caktuara me ligj”.

- Në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike“, ligj i cili në asnjë rast nuk e ka ngarkuar prokurorinë me funksione dhe detyra gjyqësore, por i ka marrë të mirëqena detyrat dhe funksionet që ligjet e sipërcituara i kanë ngarkuar asaj.

- Në vendimin nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” të Kuvendit të Shqipërisë, vendim i cili jo vetëm në tërësinë e tij por edhe në veçanti në kreu V. “Procedura e realizimit të verifikimit” të tij i ka ngarkuar Prokurorisë detyra aspak të ngjashme me ato gjyqësore, por thjesht dhe vetëm në përputhje me detyrat dhe funksionet e saj të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e sipërcituara.



Vendimi i Prokurorisë së Përgjithshme i cili kërkon heqjen e mandatit për shkaqe të paraqitura në qëndrimin e tij, nuk qëndron, pasi veprës penale të ndodhur në vitin 2003 përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme i ka dhënë një cilësim të ri juridik, tashmë sipas parashikimeve ligjore të vitit 2017.

Megjithatë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerëson se vepra penale e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, për të cilën akuzohet dhe është dënuar z. Adrian Marku, nga pikëpamja e teknikës legjislative, është vepër penale e cila pozicionuar në seksionin e III të kreut VIII të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, kreu i cili titullohet “Krim kundër autoritetit të shtetit”.

Qëllimi i ligjit nr.138/2015 është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, sipas këtij ligji.

Objekti i këtij ligji është mbrojtja dhe garantimi i mirëfunksionimit demokratik të Kuvendit, organeve të qeverisjes vendore, institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj, administratës publike, nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikbërje dhe/ose vendimarrje e personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie, ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, sipas këtij ligji.

Qëllimi i ligjit nr.138/2015 shprehet edhe në procesverbalin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisë dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (Dokument parlamentar), datë 20.11.2015, ora 09:00, ku citohet shprehimisht se:

“... qëllimi i këtij ligji është qartazi ai për të mbrojtur institucionet dhe për të garantuar funksionimin demokratik të tyre, duke përjashtuar nga funksionimi dhe nga vendimarrja e këtyre institucioneve, nga politikbërja, të gjithë ata persona që sot janë në detyrë, apo në të ardhmen, do të synojnë të vijnë në këto institucione, por ndërkohë janë persona të cilët kanë rekorde kriminale.

Pra, qëllimi i këtij projektligji është të mbrojë funksionimin, vendimarrjen dhe politikbërjen e

institucioneve demokratike të administratës publike, nga persona, të cilët kanë rekorde kriminale dhe për këtë arsye konsiderohet me vend që këta të përjashtohen, të largohen nga këto procese të rëndësishme¹”.

Pra, në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimtaria për të cilën është dënuar subjekti vetëdeklarues z. Ardian Marku, bie ndesh me qëllimin dhe objektin e ligjit nr.138/2015, i cili në finale ka mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore në përgjithësi dhe në rastin konkret mirëfunksionimin e organeve të qeverisjes vendore në veçanti.

Me fjalë të tjera Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vlerëson se ligji nr.138/2015, nuk është dhe nuk duhet të aplikohet si një ligj penalizues, por si një ligj garantues i mirëfunksionimit të aparatit shtetëror.

Ligji nr.138/2015, nga pikëpamja e teknikës legjislative, është hartuar në mënyrë të tillë që e përcakton llojin e veprës penale dhe masën e dënimit si kushte Ndalimi për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik. Kjo gjë del qartazi edhe në procesverbalin e Procesverbalit i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisë dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (Dokument parlamentar), datë 20.11.2015, ora 09:00 ku citohet më poshtë shprehimisht se:

“Ky projektligj për herë të parë përcakton në kuadrin legjislativ shqiptar kufizime, të cilat lidhen në mënyrë proporcionale me shkallën e rrezikshmërisë sociale të personave, të cilët kanë kryer krime në të shkuarën apo eventualisht në të ardhmen, do të kryejnë krime dhe do të dënohen apo janë në proces gjykimi nga drejtësia për krimet që janë kryer. Mbi bazën e këtyre vendimeve të marra nga gjykatat apo masave të lëshuara nga autoritet gjyqësore apo autoritete të tjera, personat do të kufizohen për të ushtruar funksione publike apo për t'u zgjedhur për periudha të caktuara, që fillojnë nga periudha e ndalimit përjetë, për persona që kanë kryer krime të rënda, deri në periudha më të shkurtra në vartësi të shkeljes dhe krimit që ata kanë bërë.

¹ Procesverbal i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisë dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (Dokument parlamentar), datë 20.11.2015, ora 09:00, faqe 2



“... te neni 2. Kushtet e kandidimit për t'u zgjedhur. Është një nen i detajuar. Pika 1 ka katër paragrafë që detajojnë, po themi kriteret e ndalimit për kandidim, për zgjedhje, për emërim dhe për ushtrim funksioni. Grupi i parë janë po themi, krimet e rënda. Grupi i dytë janë veprat penale të korrupsionit dhe zgjedhjeve të lira. I treti janë dënime me dy vjet e sipër, pra ka një lloj graviteti, dhe ato që janë gjashtë muaj e sipër, por që e kanë më të shkurtër periudhën e ndalimit. Qëllimi i tij është proporcionaliteti. Proporcionaliteti në këtë ndalim, mbi bazën e asaj që është caktuar më parë nga gjykatat, për krimin që kanë kryer...”².

Në paragrafin e parë të nenit 2 të tij, i vetmi nen i që bën diferencën me nenet e tjerë, që janë cituar të plotë dhe në tërësinë e tyre, është neni 278, që bën referime në 3 paragrafë të tij, dhe jo në tërësinë e tij. Për këtë grupim veprash penale ligji nr.138/2015 ka parashikuar ndalimin për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të mandatit zgjat gjatë gjithë jetës. Pra, janë konsideruar vepra penale të rënda.

Qëllimi i një zgjedhje të tillë legjislative është për të shmangur praninë në kuvendet e zgjedhura, personat e gjykuar moralisht si të padenjë. Ndërkohë që kemi një ligj, i cili nuk parashikon penalizimet, përtej asaj çfarë është penalizimi i bërë nga gjykatat, për veprat penale të personave, të cilët duhet të largohen nga funksionet publike, të zgjedhura apo të emëruara. Pra, ky ligj synon vetëm mbrojtjen e institucioneve demokratike nga influenca në politikëbërje dhe vendimmarrje të këtyre individëve³. Pra qëllimi i legjislatorit është shprehur qartë që askush nuk mund të dalë tej vendimeve të gjykatave, qoftë edhe nga organi i porkuroresë.

Ligji nr.138/2015, “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, duke disiplinuar kushtet dhe kërkesat për të hyrë dhe për të mbajtur një detyrë apo funksion publik, legjislatori përpiqet të vendosë një balancim ndërmjet të drejtës së elektoratit pasiv,

apo subjektit të emëruar nga njëra anë dhe mbarëvajtjen apo mirëfunksionimin e administrativ nga ana tjetër.

Balancimi delikat ndërmjet të drejtave të elektoratit pasiv dhe mbrojtjes së funksionimit të mirë të administratës publike, është një çështje që edhe nga praktika e vendeve të zhvilluara⁴ është trajtuar deri në nivel kushtetues dhe konkluzioni ka qenë se ka një interes të përgjithshëm publik për të shmangur një rol aktiv të shkelësve në vendimmarrjen politike. Interesi publik prevalon ndaj interesave të individëve, qofshin këta edhe të zgjedhur.

Interesi publik lidhet me qëllimin e normës ligjore në këtë rast, që është, garantimi i besueshmërisë së administratës ndaj publikut, do të thotë, raporti i besimit të qytetarëve ndaj institucioneve dhe interpretimi i Komisionit Qendror të zgjedhjeve në këtë rast duhet të jetë dhe është i lidhur ngushtësisht me ratio –n e ligjit.

Nuk duket e paarsyeshme që, duke qenë se mund të dyshohet se ndotet ose të humbasë imazhi i aparatit publik, që mund të rrjedhë nga vazhdimi në detyrë i një funksionari në kushtet ligjore që shpjeguar më sipër.

Përballë një situatë të rëndë paligjshmërie në administratën publike, në fakt nuk është e paarsyeshme marrja e një vendimi për subjektin vetëdeklarues që ka kryer krimin në fjalë (përsa kohë është një krim që është drejtuar kundër autoritetit të shtetit) të vijohet me vendimmarrjen e heqjes së mandatit të subjektit vetëdeklarues, për të evituar një “ndotje” të administratës publike dhe për të garantuar “besueshmërinë” e administratës publike ndaj publikut, që do të thotë raporti i besimit ndërmjet qytetarëve drejt institucioneve që mund të rrezikojë të plasarit nga “hija” rënduese mbi të, për shkak të akuzës me të cilën është goditur një person nëpërmjet të cilit vetë institucioni vepron”⁵

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerëson, se heqja e mandatit të një anëtarit të zgjedhur të një bashkie, dënuar me 6 muaj burgim, për një veprë penale të rëndë dhe të drejtuar kundër autoritetit të shtetit, është e justifikuar racionalisht nga qëllimi për të shmangur praninë në një organ demokratik

² Procesverbal i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisëse dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (Dokument parlamentar), datë 20.11.2015, ora 09:00, Faqe 18

³ Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisëse dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (Dokument parlamentar), procesverbal datë 23.11.2015, ora 18:00, faqe 2

⁴ Për më gjerë, shiko sentenca nr. 236, viti 2015 Gjykata Kushtetuese italiane

⁵ Për më gjerë, shiko sentenca n. 206, viti 1999 Gjykata Kushtetuese Italiane



të një personi i cili është moralisht i padenjë. “Kur një kriminel apo një hajdut bën faj dhe kapet, rregulli bazë është që nuk përfiton dot nga produkti i veprës së tij”⁶.

Përveç sa më sipër, referuar edhe në tërësinë e tij raportit paraprak, “Për përjashtimin e shkelësve të ligjit nga parlamenti”, opinionin nr.807/2015 të Komisionit Evropian për Demokraci përmes ligjit (Komisioni i Venecias), miratuar nga Këshilli i Zgjedhjeve Demokratike, në mbledhjen e tij të 51-të (Venecia, 18 qershor 2015) dhe nga Komisioni i Venecias në sesionin e tij plenar të 103-të (Venecia, 19-20 qershor 2015), dhe në veçanti, paragrafëve 133 dhe 144 të tij cituar si më poshtë:

“133. siç thuhet dhe në vendimin e Gjykatës Europiane për të drejtat e njeriut, shtrëngimet duhet të kufizohen për aq sa është e nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur të demokracisë, e cila do të rrezikohet më seriozisht nga një zyrtar i zgjedhur se sa nga një votues i thjeshtë që ushtron të drejtën e tij zgjedhore aktive. Ato nuk duhet të konsiderohen si kufizues të demokracisë, por si një mjet për ta ruajtur atë”, dhe

144. Në rast se deputeti akuzohet se ka kryer një krim të rëndë, mund të ketë një interes publik për të shmangur pjesëmarrjen e atij personi në Procedurat parlamentare. Mund të niset një procedurë heqjeje. Kushtetuta Finlandeze⁷ parashikon një lloj të tillë procedure të largimit nga detyra, për deputetët të cilët në thelb dhe në mënyrë të përsëritur kanë lënë pas dore detyrat e tyre si përfaqësues. Nuk ka asnjë kufizim për ata persona për të kandiduar në zgjedhjet e ardhshme”.

Z. Adrian Luigj Marku me të dhënat për dënim për kryerjen e veprës penale, “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit” vepër penale e cila pozicionuar në Seksionin e III të kreut VIII të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, kre i cili titullohet “Krimet kundër autoritetit të shtetit”, është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit, sipas parashikimeve të nenit 2, pika 1, germa “a”, nenit 4, pika 1 të ligjit nr.138/2015.

Për sa më sipër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 179/1 të Kushtetutës,

nenit 14 dhe nenit 10, pika 1, germa “d” shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Adrian Luigj Marku.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 1, neni 10, pika 1, germa “d”, neni 14, nenin 15, pika 3 i ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V, pika 12, 13, 14 i vendimit të Kuvendit nr.17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSI:

1. Të shpall të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të këshillit të Bashkisë Lezhë z. Ardian Luigj Marku.

2. Ky vendim i njoftohet menjëherë Kryeministrit.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Denar Biba

VENDIM Nr. 161, datë 14.4.2017

PËR SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME PËR FUNKSIONARIN PUBLIK Z. XHEVDET SOPAJ, ANËTAR I KËSHILLIT TË BASHKISË KUKËS, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 14.4.2017, me pjesëmarrjen e:

Denar	Biba	kryetar
Hysen	Osmanaj	zv/kryetar
Bledar	Skënderi	anëtar

⁶ Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisë dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë Dokument parlamentar PROCESVERBAL Datë 16.09.2015, ora 14:00, faqe 5

⁷ Neni 28



Edlira Jorgaqi anëtare
Gëzim Veleshnja anëtar
Klement Zguri anëtar
Vera Shtjefni anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Xhevdet Sopaj, anëtar i këshillit të Bashkisë Kukës, në zbatim të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

BAZË LIGJORE: Neni 1, neni 10, pika 1, germa “d”, neni 14, neni 15, pika 3 i ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V, pika 12, 13, 14 i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Në zbatim të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, KQZ-ja është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:

- Deputetët të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak.

Nga verifikimi i të dhënave në Formularin e Vetëdeklarimit të z. Xhevdet Sopaj, anëtar i këshillit të Bashkisë Kukës, rezulton se ka një dënim me vendimin nr.105, datë 7.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për veprën penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar në KQZ, vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore të datës

2.6.2016 të z. Xhevdet Sopaj sipas të cilit rezulton se Z. Sopaj:

është dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, nr.93, datë 27.10.1998, për veprën penale “Lidhje pa leje në rrjetin e ujësjellësit”, parashikuar nga neni 159/2 i Kodit Penal, me 2 muaj burgim

është dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, nr.105, datë 7.11.2012, në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale me 4 muaj burgim, për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake” parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe “Prodhim dhe mbajtje pa leje të municionit” parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim duke e vënë në provë për një periudhë prej 18 (tetëmbëdhjetë muaj) me kusht.

Sipas vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore, për këto vepra penale, në bazë të nenit 69 të Kodit Penal, është rehabilituar.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit dhe vërtetimin e Gjendjes gjyqësore, rezulton se z. Xhevdet Sopaj nuk e ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit dënimin për veprën penale “Lidhje pa leje në rrjetin e ujësjellësit”, parashikuar nga neni 159/2 i Kodit Penal sipas vendimit nr.93, datë 27.10.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr.1083/2 extra, datë 20.6.2016 i ka kërkuar KQZ-së verifikimin e të dhënave të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit të z.Xhevdet Sopaj. KQZ pas shqyrtimit të të dhënave në dokumentacionin e z. Xhevdet Sopaj, vendosi t’ia kalojë rastin për kontroll të thelluar, Prokurorisë së Përgjithshme.

Më shkresën nr.1083/20, datë 4.4.2017, Prokuroria e Përgjithshme, ka dërguar në KQZ, vendimin e rezultatit të verifikimit për z. Xhevdet Sopaj, me detyrë anëtar i Këshillit të Bashkisë Kukës.

Në përfundim të procesit, Prokuroria e Përgjithshme ka analizuar veprën dhe dënimin e vendimit nr. 105, datë 7.11.2012, të Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës dhe ka konkluduar se:

Neni 2, pika 1, germa “a” e ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione



publike”, ndalohen të zgjidhen, të emërohen apo të ushtrojnë një funksion publik personat që kryejnë një krim të parashikuar nga neni 278 paragrafi parë, të pestë e të gjashtë, i Kodit Penal.

Në momentin që ka hyrë në fuqi ligji nr.138/2015, neni 278, parashikon përkatësisht këto paragrafë,

- (1)prodhimin e armëve dhe municioneve luftarake;

- (5)mbajtjen e armëve, e bombave apo minave , ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të automatizuar, në mjedise publike;

- (6)kur vepra penale është kryer në sasi të mëdha , në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja;

Nëse i referohemi rastit konkret, në arsyetimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, në vendimin e sipërcituar, sqarohet se subjekti e ka kryer veprën penale të armëmbajtjes pa leje, në mjedise publike, (në makinë, në rrugë). Forcat e policisë së Komisarariatit Kukës, kanë shkuar te vendi i ngjarjes dhe kanë parë që i pandehuri po debatonte me disa persona të tjerë. Gjatë kontrollit të ushtruar nga policia këtij automjeti është konstatuar se i pandehuri mbante brenda automjetit një armë, pushkë, me nr. 90307510 me një karikatorë me 17 fishekë. Pavarësisht se në momentin e kryerjes së veprës penale, dispozita e nenit 278 të Kodit Penal nuk e parashikonte si paragraf të ndarë më vete (armëmbajtjen pa leje në mjedise publike) dhe pavarësisht faktit që ky nen ka ndryshuar disa herë ndër vite, ligji nr. 138/2015 përcakton qartësisht se në vlerësim të anës objektive, armëmbajtja pa leje në mjediset publike përfshihet si ndalim në nenin 2, pika 1, germa “a të ligjit nr.138/2015.

Prokuroria e Përgjithshme në vlerësim të anës objektive ka ndryshuar referencën e dispozitës të Kodit Penal, për klasifikimin e veprës penale për të cilën z. Xhevdet Sopaj ka marrë dënimin me burgim sipas vendimit nr.105, datë 07.11.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, nga neni 287, paragrafi 2 i Kodit Penal, në kohën e kryerjes së veprës penale, në nenin 287, paragrafi 5 i Kodit Penal në fuqi në kohën e miratimit të ligjit nr.138/2015.

Në përfundim Prokuroria vendosi: përfundimin e verifikimeve dhe konstatimin se subjekti deklarues z. Xhevdet Sopaj, anëtar i këshillit Bashkiak Kukës përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa “a” të ligjit nr.138/2015 “Për

garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Nga verifikimi i dokumentacionit formularit të vetedeklarimit vërtetimit të gjendjes gjyqësore, KQZ-ja konstaton se:

Zoti Xhevdet Sopaj, anëtar i Këshillit Bashkiak Kukës është dënuar në vitin 2012 për kryerje të veprës penale, “Prodhimi dhe mbajta pa leje e armëve luftarake dhe e municioneve” parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

Ne ligjin nr.138/2015 ne nenin 2 pika 1 germa “a” veç te tjerash thuhet se: “... nuk mund të kandidojë e as të zgjidhen deputet në Kuvendin e Shqipërisë, Kryetar Bashkie apo Këshilltar në Këshillat Bashkiak ... personat që janë dënuar me vendim të formës së prerë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për: a) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve....278, paragrafi i parë, i pestë dhe i gjashtë...”.

Në kohën e dënimit të zotit Xhevdet Sopaj vepra penale “Prodhimi dhe mbajta pa leje e armëve luftarake dhe e municioneve”, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal kishte tre paragrafë dhe në paragrafin e dytë dispozita parashikonte një dënim i cili varionte nga gjobë deri me burgim në 7 vjet.

Në vendimin e datës 3.4.2017 të Prokurorisë së Përgjithshme, është bërë një interpretim i vendimit penal të dënimit të zotit Xhevdet Sopaj, duke analizuar njërin prej elementeve të veprës penale, atë të anës objektive.

Prokuroria e Përgjithshme thotë midis të tjerash në vendimin e saj se “...nëse i referohemi rastit konkret, në arsyetimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës në vendimin e sipërcituar, sqarohet se subjekti e ka kryer veprën penale të armëmbajtjes pa leje, në mjedise publike. Pavarësisht se në momentin e kryerjes së veprës penale, dispozita e nenit 278 të Kodit Penal nuk e parashikonte si paragraf të ndarë më vete armëmbajtjen pa leje në mjedise publike dhe pavarësisht faktit se ky nen ka ndryshuar disa herë ndër vite siç e arsyetua më sipër ligji 138/2015, përcakton qartësisht se në vlerësim të anës objektive armëmbajtja pa leje në ambiente publike, përfshihet në ndalimet e nenin 2 pika 1 germa “a” e këtij ligji...”.

Në lidhje me këtë arsyetim të vendimit të Prokurorisë të Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shprehet se:



Së pari, Prokuroria e Përgjithshme sipas ligjit 138/2015 ngarkohet që të bëjë verifikim të thelluar të të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, me iniciativë të saj apo edhe me kërkesë të institucioneve përkatëse. Pra ky organ, sipas këtij ligji është i detyruar që të administrojë vendime penale dënimi, vendime arresti brenda e jashtë vendit, urdhra dëbimi etj.

Në interpretimin që i ka bërë vendimit penal me nr.105, datë 7.11.2012, dhe më konkretisht anës objektive të veprës penale të kryer nga subjekti vetëdeklarues, ky organ në vendimin e tij të datës 03.04.2017 nuk u ka dhënë përgjigje disa dyshimeve dhe konkretisht:

- Ku qëndron ngjashmëria midis nenit 278 (sipas parashikimit të ligjit penal të kohës, të vitit 2012) për të cilën është dënuar subjekti vetëdeklarues Xhevdet Sopaj i cili e ka masën e dënimit nga gjobë deri në 7 vjet burgim, dhe nenit 278 (ligji penal në aktual) që i referohet Prokuroria i cili e ka masën e dënimit nga 3 deri në 7 vjet burgim ?

Lehtësisht dallohet një diskordancë shumë e madhe me masat e dënimit të cilat patjetër kanë qenë kritere në caktimin e dispozitave me karakter përjashtues në zbatim të ligjit 138/2015. Pra, legjislatori, ndryshe nga sa ishte parashikuar më parë ka vendosur një masë dënimi dysheme më të madhe se sa parashikohej në vitin 2012, gjë e cila do të thotë një qëndrim i ashpër në lidhje me këtë veprimtari antiligjore. Cila ka qenë arsyeja e barazimit të këtyre dispozitave për llogari të ligjit 138/2015 nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme ?

- Njohjen apo interpretimet e vendimeve penale, legjislacioni penal shqiptar këtë të drejtë ia njeh vetëm organeve gjyqësore. Janë këto organe që mund dhe duhet që të bëjnë interpretimin e vendimeve penale. A jemi përpara tejkallimit të veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme kur ajo interpreton vendimin gjyqësor, anën objektive të veprës penale për të cilën është dënuar subjekti vetëdeklarues?

Së dyti, dispozita penale të cilës i referohet organi i akuzës ka një masë dënimi nga 3 deri në 7 vjet burgim çka tregon seriozitetin që ligjvënësi i kushton kësaj veprimtarie keqpërëse. Ashpërsimi i masës së dënimit në minimum, referuar qëndrimit të Prokurorisë së Përgjithshme, duket se ndodhemi përpara një cilësimi të ri të veprës penale të kryer nga subjekti vetëdeklarues z. Xhevdet Sopaj në

vitin 2012. Është parim i gjithëpranuar në doktrinën e së drejtës penale se ligji penal ndëshkues nuk ka fuqi prapavepruese. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Theksojmë se sa më sipër, është në përputhje të plotë edhe më parashikimet e nenit 29 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

As Prokuroria e Përgjithshme e aq më pak Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk mund të ngrenë akuzën jashtë një procesi gjyqësor. Janë këto dallime midis veprës së kryer dhe asaj që i referohemi për heqjen e mandatit që e kanë lejuar gjykatën për të aplikuar lehtësirat e parashikuara në ligjin penal.

Detyrat dhe funksionet e organit të prokurorisë janë të mirëpërcaktuara në një grupim ligjesh, duke filluar nga:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e cila në nenin 148 të saj, paragrafi i parë parashikon shprehimisht se:

“1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. Detyra konkrete të saj janë parashikuar në ligjin organik të saj e konkretisht në ligj”.

- Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 “Objekti i veprimtarisë së prokurorisë” ku parashikohet shprehimisht se:

“1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të caktuara me ligj”.

- Në ligjin nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ligj i cili në asnjë rast nuk e ka ngarkuar prokurorinë me funksione dhe detyra gjyqësore, por i ka marrë të mirëqena detyrat dhe funksionet që ligjet e sipërcituara i kanë ngarkuar asaj.

- Në vendimin nr.17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” të Kuvendit të Shqipërisë, vendim i cili jo vetëm në tërësinë e tij por edhe në veçanti në Kreu V. “Procedura e realizimit të verifikimit” të tij i ka ngarkuar



Prokurorisë detyra aspak të ngjashme me ato gjyqësore, por thjesht dhe vetëm në përputhje me detyrat dhe funksionet e saj të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e sipërcituara.

Vendimi i Prokurorisë së Përgjithshme, i cili kërkon heqjen e mandatit për shkaqe të paraqitura në qëndrimin e tij, nuk qëndron, pasi veprës penale të ndodhur në vitin 2012 Prokuroria e Përgjithshme i ka dhënë një cilësim të ri juridik tashmë sipas parashikimeve ligjore të vitit 2017.

Megjithatë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerëson se vepra penale e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, për të cilën akuzohet dhe është dënuar z.Xhevdet Sopaj, nga pikëpamja e teknikës legjislative, është veprë penale e cila pozicionuar në Seksionin e III të kreut VIII të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, kre i cili titullohet “Krime kundër autoritetit të shtetit”.

Qëllimi i ligjit 138/2015 është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, sipas këtij ligji.

Objekti i këtij ligji është mbrojtja dhe garantimi i mirëfunksionimit demokratik të Kuvendit, organeve të qeverisjes vendore, institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj, administratës publike, nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikëbërje dhe/ose vendimmarrje të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, sipas këtij ligji.

Qëllimi i ligjit 138/2015 shprehet edhe në procesverbalin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisëse dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (Dokument parlamentar), datë 20.11.2015, ora 09:00, ku citohet shprehimisht se:

“...“... qëllimi i këtij ligji është qartazi ai për të mbrojtur institucionet dhe për të garantuar funksionimin demokratik të tyre, duke përjashtuar nga funksionimi dhe nga vendimmarrja e këtyre institucioneve, nga politikëbërja, të gjithë ata persona që sot janë në detyrë, apo në të ardhmen,

do të synojnë të vijnë në këto institucione, por ndërkohë janë persona të cilët kanë rekorde kriminale.

Pra, qëllimi i këtij projektligji është të mbrojë funksionimin, vendimmarrjen dhe politikëbërjen e institucioneve demokratike të administratës publike, nga persona, të cilët kanë rekorde kriminale dhe për këtë arsye konsiderohet me vend që këta të përjashtohen, të largohen nga këto procese të rëndësishme⁸”.

Pra, në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimtaria për të cilën është dënuar subjekti vetëdeklarues z. Xhevdet Sopaj bie ndesh me qëllimin dhe objektin e ligjit nr.138/2015 i cili në finale ka mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore në përgjithësi dhe në rastin konkret mirëfunksionimin e organeve të qeverisjes vendore në veçanti.

Me fjalë të tjera Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerëson se ligji 138/2015 nuk është dhe nuk duhet të aplikohet si një ligj penalizues por si një ligj garantues i mirëfunksionimit të aparatit shtetëror.

Ligji 138/2015, nga pikëpamja e teknikës legjislative, është hartuar në mënyrë të tillë që e përcakton llojin e veprës penale dhe masën e dënimit si kushte; Ndalimi për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik. Kjo gjë del qartazi edhe në procesverbalin e Procesverbali i Komisionit të Posaçëm Parlamentar, për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisëse dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (Dokument parlamentar), datë 20.11.2015, ora 09:00 ku citohet më poshtë shprehimisht se:

“Ky projektligj për herë të parë përcakton në kuadrin legjislativ shqiptar kufizime, të cilat lidhen në mënyrë proporcionale me shkallën e rrezikshmërisë sociale të personave, të cilët kanë kryer krime në të shkuarën apo eventualisht në të ardhmen, do të kryejnë krime dhe do të dënohen apo janë në proces gjykimi nga drejtësia për krimet që janë kryer. Mbi bazën e këtyre vendimeve të marra nga gjykatat apo masave të lëshuara nga autoritet gjyqësore apo autoritete të tjera, personat do të kufizohen për të ushtruar funksione publike

⁸ Procesverbali i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisëse dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (dokument parlamentar), datë 20.11.2015, ora 09:00, faqe 2



apo për t'u zgjedhur për periudha të caktuara, që fillojnë nga periudha e ndalimit përjetë, për persona që kanë kryer krime të rënda, deri në periudha më të shkurtra në vartësi të shkeljes dhe krimit që ata kanë bërë⁹.

“... te neni 2. Kushtet e kandidimit për t'u zgjedhur. Është një nen i detajuar. Pika 1 ka katër paragrafë që detajojnë, po themi, kriteret e ndalimit për kandidim, për zgjedhje, për emërim dhe për ushtrim funksioni. Grupi i parë janë po themi, krimet e rënda. Grupi i dytë janë veprat penale të korrupsionit dhe zgjedhjeve të lira. I treti janë dënime me dy vjet e sipër, pra ka një lloj graviteti, dhe ato që janë gjashtë muaj e sipër, por që e kanë më të shkurtër periudhën e ndalimit. Qëllimi i tij është proporcionaliteti. Proporcionaliteti në këtë ndalim, mbi bazën e asaj që është caktuar më parë nga gjykatat, për krimin që kanë kryer...”¹⁰.

Në paragrafin e parë të nenit 2 të tij, i vetmi nen që bën diferencën me nenet e tjerë, që janë cituar të plotë dhe në tërësinë e tyre, është neni 278, që bën referime në 3 paragrafë të tij, dhe jo në tërësinë e tij. Për këtë grupim veprash penale ligji nr.138/2015, ka parashikuar ndalimin për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të mandatit gjatë gjithë jetës. Pra, janë konsideruar vepra penale të rënda.

Qëllimi i një zgjedhje të tillë legislative është për të shmangur praninë në kuvendet e zgjedhura, personat e gjykuar moralisht si të padenjë. Ndërkohë që kemi një ligj, i cili nuk parashikon penalizimet, përtej asaj çfarë është penalizimi i bërë nga gjykatat, për veprat penale të personave, të cilët duhet të largohen nga funksionet publike, të zgjedhura apo të emëruara. Pra, ky ligj synon vetëm mbrojtjen e institucioneve demokratike nga influenca në politikëbërje dhe vendimmarrje të këtyre individëve¹¹. Pra qëllimi i legjislatorit është

shprehur qartë që askush nuk mund të dalë tej vendimeve të gjykatave, qoftë edhe nga organi i prokurorisë.

Ligji nr.138/2015, “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, duke disiplinuar kushtet dhe kërkesat për të hyrë dhe për të mbajtur një detyrë apo funksion publik, legjislatori përpiket të vendosë një balancim ndërmjet të drejtës së elektoratit pasiv apo subjektit të emëuar nga njëra anë dhe mbarëvajtjen apo mirëfunksionimin e administrativ nga ana tjetër.

Balancimi delikat ndërmjet të drejtave të elektoratit pasiv dhe mbrojtjes së funksionimit të mirë të administratës publike, është një çështje që edhe nga praktika e vendeve të zhvilluara¹² është trajtuar deri në nivel kushtetues dhe konkluzioni ka qenë se ka një interes të përgjithshëm publik për të shmangur një rol aktiv të shkelësve në vendimmarrjen politike. Interesi publik prevalon ndaj interesave të individëve, qofshin këta edhe të zgjedhur.

Interesi publik lidhet me qëllimin e normës ligjore në këtë rast, që është, garantimi i besueshmërisë së administratës ndaj publikut, do të thotë, raporti i besimit të qytetarëve ndaj insitucioneve dhe interpretimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në këtë rast duhet të jetë dhe është i lidhur ngushtësisht me ratio –n e ligjit.

Nuk duket e paarsyeshme që, duke qenë se mund të dyshohet se ndotet ose të humbasë imazhi i aparatit publik që mund të rrjedhë nga vazhdimi në detyrë i një funksionari në kushtet ligjore që spjeguar më sipër.

Përballë një situatë të rëndë paligjshmërie në administratën publike, në fakt, nuk është e paarsyeshme marrja e një vendimi për subjektin vetëdeklarues që ka kryer krimin në fjalë (përsa kohë është një krim që është drejtuar kundër autoritetit të shtetit) të vijohet me vendimmarrjen e heqjes së mandatit të subjektit vetëdeklarues, për të evituar një “ndotje” të administratës publike, dhe për të garantuar “besueshmërinë” e administratës publike ndaj publikut, që do të thotë raporti i besimit ndërmjet qytetarëve drejt institucioneve që mund të rrezikojë të plasarit nga “hija” rënduese

⁹ Procesverbal i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisë dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (dokument parlamentar), datë 20.11.2015, ora 09:00, faqe 2

¹⁰ Procesverbal i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisë dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (dokument parlamentar), datë 20.11.2015, ora 09:00, faqe 18

¹¹ Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisë dhe Opozitës në Kuvendin e Faqe| 5552

Shqipërisë Dokument parlamentar, PROCESVERBAL datë 23.11.2015, ora 18:00, faqe 2

¹² Për më gjerë, shiko sentenca nr. 236, viti 2015 Gjykata Kushtetuese italiane



mbi të për shkak të akuzës me të cilën është goditur një person nëpërmjet të cilit vetë institucio ni vepron”¹³

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vlerëson se heqja e mandatit të një anëtarit të zgjedhur të një bashkie, dënuar me 6 muaj burgim për një veprë penale të rëndë dhe të drejtuar kundër autoritetit të shtetit është e justifikuar racionalisht nga qëllimi për të shmangur praninë në një organ demokratik të një personi i cili është moralisht i padenjë. “Kur një kriminel apo një hajdut bën faj dhe kapet, rregulli bazë është që nuk përfiton dot nga produkti i veprës së tij”¹⁴

Përvec sa më sipër, referuar edhe në tërësinë e tij raportit paraprak, “Për Përfundimin e Shkelësve të Ligjit nga Parlamenti”, opinionin nr.807/2015 të Komisionit Evropian për Demokraci përmes ligjit (Komisioni i Venecias), miratuar nga Këshilli i Zgjedhjeve Demokratike, në mbledhjen e tij të 51-të (venecia, 18 qershor 2015) dhe nga Komisioni i Venecias në sesionin e tij plenar të 103-të (Venecia, 19-20 qershor 2015), dhe në vecanti, paragrafit 133 dhe 144 të tij cituar si më poshtë:

“133. siç thuhet dhe në vendimin e Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut, shtrëngimet duhet të kufizohen për atë që është e nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur të demokracisë, e cila do të rrezikohet më seriozisht nga një zyrtar i zgjedhur se sa nga një votues i thjeshtë që ushtron të drejtën e tij zgjedhore aktive. Ato nuk duhet të konsiderohen si kufizues të demokracisë, por si një mjet për ta ruajtur atë”, dhe

144. Në rast se deputeti akuzohet se ka kryer një krim të rëndë, mund të ketë një interes publik për të shmangur pjesëmarrjen e atij personi në Procedurat parlamentare. Mund të niset një procedurë heqjeje. Kushtetuta Finlandeze¹⁵ parashikon një lloj të tillë procedure të largimit nga detyra për deputetët të cilët në thelb dhe në mënyrë të përsëritur kanë lënë pas dore detyrat e tyre si përfaqësues. Nuk ka asnjë kufizim për ata persona për të kandiduar në zgjedhjet e ardhshme”.

Z. Xhevdet Sopaj me të dhënat për dënim për kryerjen e veprës penale, “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, veprë penale e cila pozicionuar në Seksionin e III të kreut VIII të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, kre i cili titullohet “Krim kundër autoritetit të shtetit” është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit, sipas parashikimeve të nenit 2, pika 1, germa “a”, nenit 4, pika 1 të ligjit 138/2015.

Për sa më sipër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 179/1 të Kushtetutës, nenit 14 dhe nenit 10, pika 1, germa “d” shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Kukës z. Xhevdet Sopaj.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 1, neni 10, pika 1, germa “d”, neni 14, nenin 15, pika 3 i ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V, pika 12, 13, 14 i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSI:

1. Të shpall të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të këshillit të Bashkisë Kukës z. Xhevdet Hajdin Sopaj.

2. Ky vendim i njoftohet menjëherë Kryeministrit.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Denar Biba**

¹³ Për më gjerë, shiko sentenca n. 206, viti 1999 Gjykata Kushtetuese Italiane

¹⁴ Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisë dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë Dokument parlamentar PROCESVERBAL Datë 16.09.2015, ora 14:00, faqe 5

¹⁵ Neni 28

**KËRKESË****Nr. 2498, datë 21.4.2017****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rehabilitimi i qendrës së fshatit Brataj” Selenicë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Selenicë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe

të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerësimit të tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale shpronësimit është 2,252,508 (dy milionë e dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I ZHVILLIMIT
URBAN
Alfred Dalipi

LISTA E PASURIVE QË PREKEN NGA PROJEKTI:
“Rehabilitimi i Qendrës së Fshatit Brataj”

Nr	ZK	Nr. Pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaq e Truallit	Sipërfaq e Ndërtimit	Çmimi i Truallit Lekë/m²	Çmimi i Ndërtimit Lekë/m²	Vlera e Truallit Lekë	Vlera e Ndërtimit Lekë	Vlera e Truall dhe Ndërtimit	Shënime
1	1265	478/8	Brataj	Spiro Avdulla Seraj	185 m2	75m2	384	25 000	71,040	2,181,468	2,252,508	Udhëzim KM Nr.3 date 28.12.2016, VKM Nr.89, date 03.02.2016

VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT

2,252,508 lekë

V:0: Çmimet e truallit VKM 89 date 03.02.2016
Çmimi i ndërtimit nga Udhëzim KM Nr.3 date 28.12.2016,

KËRKESË**Nr. 2565, datë 25.4.2017****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rivitalizim i pjesshëm pranë rrugës pedonale ‘Abaz Bej Lushnja’ Lushnjë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të

vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr.89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerësimit të tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale shpronësimit është 320,397 (treqind e njëzetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I ZHVILLIMIT
URBAN
Alfred Dalipi



Vlera e shpronësimit e truallit të z. Shaban Daut Beqiri
Ne lagjen "Kongresi" Zona kadastrale 8571

INVESTITORI : BASHKIA LUSHNJË

Nr	N/ pasuris	Emri Mbicuri	Zona kadastrale	Lloji i pronës	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRRP-ja
1	18/19	Shaban Daut Beqiri	8571	Truall	m2	33	9709	320397	Shkresa Nr.1921/1 date 20.03.2017
Shuma totale								320397	

KËRKESË

Nr. 2601, datë 26.4.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Rikonstruksion i shkollës së mesme të përgjithshme '18 Tetori' Lushnjë".

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të

vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, si dhe të vendimit nr.89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale shpronësimit është 92,226 (nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I ZHVILLIMIT
URBAN
Alfred Dalipi

Vlera e shpronësimit e truallit të znj. Drita Ymer Guçe + bashkpronare
Ne lagjen "Skender Libohova" Zona kadastrale 8572

INVESTITORI : BASHKIA LUSHNJË

Nr	N/ pasuris	Emri Mbicuri	Zona kadastrale	Lloji i pronës	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRRP-ja
1	9/82	Drita Ymer Guçe +bashkpronare	8572	Truall	m2	10.3	8954	92 226	Shkresa Nr.663/1 date 30/01/2017
Shuma totale									

KËRKESË

Nr.1356/5, datë 26.4.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Rikonstruksioni i rrugës "Unaza e jashtme e qytetit", Bashkia Gjirokastrë.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Bashkia e Gjirokastrës.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në

bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.



Vlera totale shpronësimit është 4 349 310 (katër milionë e treqind e dyzet e nëntë mijë e treqind e dhjetë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTËR I PUNËVE TË
BRENDSHME
Elona Gjebrea**

Lista e emërora e personave dhe pronave që do të shpronësohen për realizimin e projektit
“Rikonstruksion i rrugës “Unaza e jashtme e qytetit”

Bashka Gjirokastrë

Nr	Emri Mbiemri	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip e truallit/m ²	Çmimi i truallit/lek	Vlera e përgjithshme /lek	Lloji i dokumentit
1	Bashkëpronarët Agron Kallfa Bujar Kallfa Manushaqe Kallfa Saide Kallfa Ismail Kallfa	8541	20/24	894	4865	4 349 310	Vërtetim pronësie
	Totali					4 349 310	

KËRKESË

Shtetasja Enerjeta Muça kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë shpalljen të zhdukur të nënës së saj shtetases Tefta Kallaku, si dhe caktimin si kujdestare në administrimin e pasurisë së saj shtetasen Enerjeta Muça.

**KËRKUESE
Enerjeta Muça**

KËRKESË

Shtetasi Gëzim Musa Dulja, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, shpalljen të zhdukur të shtetasen Vathe Musa Dulja.

**KËRKUES
Gëzim Dulja**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 280 lekë